

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6102
E martë, 1 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve për EULEX-in, i ulët I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SPEKTRI POLITIK NË KOSOVË NUK KA ARRITUR KONSSENSUS NACIONAL PËR TAKIMIN NË UASHINGTON I FAQE 4-5

DELEGACIONI I KOSOVËS SHKON NË UASHINGTON PA OPOZITËN

Pa konsensus nacional ka udhëtuar delegacioni i Kosovës për Uashington, ku më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë do të takohet me delegacionin e Serbisë në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Delegacioni përbëhet vetëm nga përfaqësuesit e partive të koalicionit qeverisës, ndërsa opozita e ka refuzuar pjesëmarrjen. Njohësit e rrethanave politike i kanë kritikuar pozitën dhe opozitën për mosunifikim të qëndrimeve për këtë çështje. Sipas tyre, mosunifikimi i spektrit politik i Kosovës për dialogun me Serbinë do të dobëson pozicionin e Kosovës në këtë proces



OPINION

NË ZONËN E CAHANIT NUK KA PASUR LËVIZJE NGA JASHTË BRENDA SHOIPËRISË (41) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



SENATORI I AMERIKËS BOB DOLE KTHEHET NË PRISHTINË I DERDHUR NË BRONZ F. 13

Ismet
SYLEJMANI



AKTUALE

PARTIA E GJUKANOVIQIT DEL E PARA NË ZGJEDHJE, SHOIPTARËT FITOJNË DY DEPUTETË F. 2

DISKUTOHET PËR SHITESAT NË PAGË PËR PUNONJËSIT SHËNDETËSORË F. 4

EKONOMI

FERMERËT E RAHOVECIT QË JANË DËMTUAR NGA BRESHRI DHE VËRSHIMET KËRKOJNË QË T'U BËHEN PAGESAT F. 8

ZGJATET AFATI PËR APLIKIM PËR PROGRAMIN E VETËPUNËSIMIT PËR PERSONAT E RIATDHESUAR F. 8

SPORT

CHALLANDES: NDESHJET NDAJ MOLDAVISË DHE GREQISË T'I SHFRYTËZOJMË PËR BARAZHIN ME MAQEDONINË F. 18

Për periudhën gjashtëmujore, kryetarët e komunave përmbushën 364 premtime



Instituti GAP ka publikuar në platformën elektronike "Letërnjoftimi i Komunave" të dhënat më të fundit për realizimin e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2017-s. Periudha e monitorimit përfshin gjashtëmujorin e parë të 2020-s. Nga gjithsej 903 premtime të evidentuara nga Instituti GAP, deri në muajin qershor 2020 janë përmbushur 364 premtime. Në pjesën më të madhe të periudhës së gjashtëmujorit të parë të këtij viti komunat janë përballur me gjendje të rënduar si pasojë e pandemisë Covid-19 I FAQE 7

Edhe nëntë të vdekur dhe 120 raste të reja me Covid në Kosovë I FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Partia e Gjukanoviqit del e para në zgjedhje, shqiptarët fitojnë dy deputetë

PODGORICË, 31 GUSHT - Bazuar në 98.55 për qind të mostrës së përpunuar të materialit zgjedhor, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Mal të Zi njoftoi të hënën për rezultatet paraprake të zgjedhjeve, sipas të cilave, Partia Demokratike e Socialistëve, e udhëhequr nga presidenti Millo Gjukanoviç, ka fituar 35.12 për qind të votave, ndërsa koalicioni opozitar "Për ardhmërinë e Malit të Zi", 32,54 për qind të

votave. Zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi u mbajtën të dielën, me një pjesëmarrje prej më shumë se 75-përqindësh të qytetarëve. Sipas rezultateve të KShZ-së, koalicioni "Paqja është kombi ynë" ka siguruar 12.55 për qind të votave, "E bardha në të zezë", 5.57, Socialdemokratët 4.09, Partia e Boshnjakëve, 3.81, Partia Social-Demokrate, 3.14, Lista Shqiptare, 1.61 dhe koalicioni

shqiptar "Bashkë një za" 1.16. Nisma Qytetare Kroate dhe Partia Kroate e Reformës nuk e kanë kaluar pragun. Bartësi i Listës Shqiptare për zgjedhjet e 30 gushtit në Mal të Zi, Nik Gjeloshaj, ka bërë me dije se subjektet shqiptare në nivel shteti kanë fituar 11,163 vota, apo dy deputetë. Ai ka thënë se, krahasuar me vitin 2016, kanë rritje të votave, nga një në dy deputetë.



Në Forumin e Bledit diskutohet për sigurinë evropiane dhe Ballkanin Perëndimor

Bled, 31 gusht - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, ka thënë të hënën se pa zgjerimin e Bashkimit Evropian dhe pranimin e Serbisë si anëtare e plotë e bllokut evropian nuk mund të përfundojë procesi i ndërtimit dhe i sigurisë në Evropë. Ai i bëri këto komente si pjesëmarrës i një paneli të udhëheqësve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës Qendrore në kuadër të Forumit të Bledit që po mbahet në Slloveni.

Në panelin me temë "Evropa pas Brexit-it dhe Covid-19", që filloi të hënën, Orban vlerësoi se "Evropa është në telashe" sepse ajo duhet ta rivendosë stabilitetin ekonomik për shkak të pandemisë me koronavirus. "Evropa duhet të kuptojë se nuk



është më një 'lojtare kryesore' në botë sepse tani janë Kina dhe Shtetet e Bashkuara. Në ekonominë moderne, qendra e përparimit shkencor i takon kryesisht sektorit ushtarak. Dhe

meqenëse Evropa nuk ka një ushtri, ajo nuk ka një qendër shkencore për përparimin teknologjik", ka thënë Orban. Ideja e zgjerimit të Bashkimit Evropian në Ballkanin

Perëndimor u përmend gjithashtu në fjalimin e kryeministrit të Çekisë, Andrej Babiš, i cili ka theksuar se një plan konkret për zhvillimin e sigurisë në Evropë është në

zgjerrimin e territoreve. "Ne duhet që menjëherë t'i përfshijmë Bullgarinë, Kroacinë, Rumaninë dhe Serbinë në Zonën Shengen. Ne i premtoam mikut tonë Zoran Zaev (kryeministër i Maqedonisë së Veriut) se do t'i fillojmë negociatat e anëtarësimit. Ai dhe Boyko Borisov (kryeministri i Bullgarisë) mbrojnë kufijtë tanë shumë më mirë se disa kolegë të tjerë të Shengenit", ka deklaruar Babiš.

Forumit të Bledit mbahet tash e 15 vjet dhe është një projekt i Qeverisë së Republikës së Sllovenisë që organizohet nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Sllovenisë dhe organizata qeveritare Qendra për Perspektivën Evropiane.

Shqiptarët e Luginës së Preshevës nuk presin që të jenë pjesë e qeverisë serbe

PRISHTINË, 31 GUSHT - Përfaqësuesit e shqiptarëve në Luginën e Preshevës nuk janë optimistë se do të mund të bëhen pjesë e qeverisë së re të Serbisë. Ata thonë se shqiptarët gjithmonë kanë qenë të gatshëm të punojnë për të drejtat e tyre në këtë pjesë të Serbisë.

Kryetari i Komunitetit të Bujanocit, Nagip Arifi, i cili vjen nga Partia Demokratike, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shqiptarët e Luginës kanë shprehur vullnet që të jenë pjesë e qeverisë së re me kusht që të avancohen të drejtat politike dhe individuale të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. "Sipas asaj që përmenden, shqiptarët në opinion në aspektin

negativ nga ana qeveritare e Republikës së Serbisë, nuk kemi ndonjë shpresë se shqiptarët do të jenë pjesë përbërëse e qeverisë së ardhshme", ka thënë Arifi.

Pas zgjedhjeve të 21 qershorit presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka takuar përfaqësuesit politikë të shqiptarëve. Në këtë takim është thënë se shqiptarët kanë parashtruar kërkesat e tyre për mundësinë e të qenit pjesë e qeverisë. Vuçiq nuk u ka dhënë ndonjë përgjigje në takim, derisa pala shqiptare është në pritje të një ftese tjetër para formimit të qeverisë së re.

Shqiptarët kanë shprehur interesim për të marrë pjesë në qeveri dhe kanë kërkuar

Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, postin e ndihmësministrit të Ekonomisë, atë të Sekretarit të Shtetit në Ministrinë e Arsimit dhe pozicionin e presidentit të Trupit Koordinues. Edhe kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginën e Preshevës, Ragmi Mustafa, ka pohuar për "Radion Evropa e Lirë" se është shumë e vështirë që shqiptarët të jenë pjesë e qeverisë së re të Serbisë. "Në këtë drejtim shoh mundësi të vogla minimale. Megjithatë, konsideroj se shqiptarët do të duhej të kenë një qasje pragmatike në drejtim të zgjidhjes së problemeve jetike. Për ne është e rëndësishme kjo që përfaqësuesit tanë t'i



përfaqësojnë interesat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës", ka deklaruar Mustafa. Ai ka theksuar se nëse Partia Përparimtare e udhëhequr

nga presidenti aktual në Serbi, Aleksandar Vuçiq, do ta ndryshojë diskursin e deritanishëm me shqiptarët në Serbi, duhet që ata të përfshihen në qeveri.

Edhe nëntë të vdekur dhe 120 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë raportuar nëntë raste të vdekjes së njerëzve si pasojë e infeksionit me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 120 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 122 persona

**EPOKA ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur nëntë persona si pasojë e infektimit me virusin "Korona". Po ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 122 persona dhe janë paraqitur 120 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë janë testuar gjithsej 452 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 120 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 9 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 13 454 raste nga 51 135 persona të dyshimta me virusin SARS-CoV-2 dhe 525 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 122 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 9 595 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 334", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar edhe numrin e rasteve pozitive me Covid sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 30 raste,

komuna Prizren 16 raste, komuna Gjilan 13 raste, komuna Gjakovë 11 raste, komuna Rahovec 7 raste, komuna Viti 7 raste, komuna Deçan 6 raste, komuna Vushtrri 5 raste, komuna Pejë 4 raste, komuna Ferizaj 3 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Malishevë 2 raste, komuna Obiliq 2 raste, komuna Skenderaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Fushë Kosovë, Istog, Mitrovicë, Podujevë, Shtime dhe Suharekë", ka njoftuar IKShPK-ja.

Zemaj: Nga muaji shtator i gjithë personali shëndetësor do t'i marrë shtesat

Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, ka deklaruar se Mjekimi Qendror Intensiv në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është një nga alternativat e fundit dhe kryesore të trajtimeve të rënda klinike të rasteve me Covid-19. "Përmes doktorit Naim Kuqi, falënderoj të gjithë personelin shëndetësor për punën dhe përkushtimin që tregoi për trajtimin e pacientëve me Covid-19 që janë të shtrirë në këtë klinikë. Kjo na dëshmon se edhe ne mund ta luftojmë pandeminë me fuqitë tona që i kemi. Edhe një herë nga këtu e përçojmë mesazhin për qytetarët që të kenë kujdes që të mos kemi nevojë për trajtim klinik", ka thënë Zemaj në një konferencë për medie pas vizitës në Klinikën e Mjekimit Intensiv në QKUK. Në këtë konferencë Zemaj ka folur edhe për shtesat prej 300 eurosh për personelin shëndetësor në QKUK dhe në spitale të përgjithshme. "Personeli ka marrë një pjesë të konsiderueshme të shtesave. Me ShSKUK-në jemi duke punuar për hartimin dhe draftimin e listave të personelit shëndetësor. E kemi një marrëveshje që nga shtatori i gjithë personeli do ta ketë shtesën", ka thënë Zemaj. Ndërsa ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Valbon Krasniqi, ka thënë se në javët e fundit është duke u vërejtur

një trend i lehtë i rënies së numrit të pacientëve që kërkojnë trajtim spitalor. Pavarësisht kësaj, Krasniqi ka thënë situata me Covid ende paraqitet e rënduar dhe ende ka numër të madh të pacientëve që janë duke u trajtuar në QKUK dhe në spitale rajonale. "Nuk ka mënyrë më të lehtë, më efikase dhe më pak të kushtueshme sesa bartja e maskës, kujdesi i higjienës personale dhe ruajtja e distancës fizike. Këto janë tri masat e arta që njerëzimi sot i ka në dispozicion e që unë vazhdimisht do t'u bëj thirrje qytetarëve t'i respektojnë ato", është shprehur Krasniqi. Në anën tjetër, dr. Naim Kuqi, përgjegjës i Mjekimit Qendror

Intensiv-Covid në QKUK, ka thënë se janë duke u trajtuar rastet që janë në gjendje më të rënduar shëndetësore. "Mjekimi Intensiv Qendror-Covid është i përcaktuar për trajtimin e këtyre pacientëve. Këtu bëhet trajtimi i pacientëve që janë në gjendje më të rënduar klinike, qofshin ata në maska të thjeshta 'CPAP', në mbështetje respiratore, apo të intubuar. Ne këtë punë e bëjmë me përkushtim të madh me stafin e teknikëve dhe të infermierëve që janë të trajnuar për ta bërë këtë punë si duhet", theksoi Kuqi. Aktualisht në Mjekimin Intensiv Qendror janë duke u trajtuar 12 pacientë me sëmundje Covid -19.

Kosova është duke rritur kapacitetet për t'u ballafaquar me Covid-19

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Nicola Orlando, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin në shëndetësi midis dy shteteve, veçanërisht për bashkëpunimin në këtë fushë në mes të shteteve të rajonit të Ballkanit, si dhe për masat e ndërmarra nga Kosova për menaxhimin e situatës epidemiologjike. "E njoftova ambasadorin se Kosova është duke rritur kapacitetet për t'u ballafaquar me Covid-19. Kërkova që Italia të na ndihmojë duke na dërguar

profesionistë shëndetësorë, veçanërisht mjekë të reanimacionit, anesteziologë, që me përvojën e tyre të na mbështesin në këtë kohë të pandemisë. Javë më parë ne kemi bërë marrëveshje përkatëse me palën italiane për sjelljen e disa mjekëve në Kosovë për të ndihmuar në përballje me Covid-19", ka bërë me dije Zemaj. Ai ka falënderuar shtetin e Italisë për mbështetjen e vazhdueshme që ka dhënë për Kosovën gjatë këtyre viteve, veçanërisht gjatë kësaj kohe të vështirë të pandemisë.



SPEKTRI POLITIK NË KOSOVË NUK KA ARRITUR KONSENSUS NACIONAL PËR TAKIMIN E UASHINGTONIT

DELEGACIONI I KOSOVËS SHKON

Pa konsensus nacional ka udhëtuar delegacioni i Kosovës për Uashington, ku më 4 shtator në Shtëpinë e Bardhë do të takohet me delegacionin e Serbisë në kuadër të dialogut për normalizim të marrëdhënieve në mes të dy vendeve. Delegacioni përbëhet vetëm nga përfaqësuesit e partive të koalicionit qeverisës, ndërsa opozita ka refuzuar pjesëmarrjen. Njohësit e rrethanave politike kanë kritikuar pozitën dhe opozitën për mosunifikim të qëndrimeve për këtë çështje. Sipas tyre, mosunifikimi i spektrit politik i Kosovës për dialogun me Serbinë dobëson pozicionin e Kosovës në këtë proces

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 31 GUSHT - Delegacioni i Kosovës, i kryesuar nga kryeministri Avdullah Hoti, ka udhëtuar të hënën për në Uashington pa përfaqësuesit e opozitës. Ndonëse synohej një konsensus nacional për këtë takim, një gjë e tillë nuk është arritur.

Dy subjektet politike opozitare, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës, kanë refuzuar t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre në delegacionin shtetëror për arsye të ndryshme.

Ndërsa njohësit e rrethanave politike kanë kritikuar këtë qasje të spektrit politik të Kosovës. Ata kanë bërë me dije se mosunifikimi i qëndrimeve për këtë çështje dobëson pozicionin e Kosovës në këtë proces.

Analisti politik Behxhet Shala ka thënë për gazetën "Epoka e re" se konsensusi i spektrit politik për dialogun do ta fuqizonte pozicionin e Kosovës në këtë

proces. "Mendoj se po ta kishin një qëndrim konsensual në këtë takim do të ishim më të fortë, më bindës, më kredibilë dhe natyrisht se do të na merrnin më seriozisht. Kështu, nëse partitë opozitare janë jashtë lojës, pra jashtë bisedimeve, atëherë është joserioze të mendohet se Avdullah Hoti do të mund të bëjë diçka. Duke i lënë anash 53 deputetë shqiptarë, kryeministri nuk do të mund të marrë ndonjë vendim i cili do të kishte një interes strategjik apo përcaktues për të ardhmen e Kosovës", ka thënë Shala. Ai ka deklaruar se refuzimi i opozitës për të marrë pjesë në takimin e Uashingtonit është në përputhje me mandatin e saj opozitar. Sipas Shalës, në këtë drejtim fajin e ka qeveria. "Çdo gjë është bërë me vonesë nga ana e qeverisë në këtë drejtim. Më tepër ka pasur deklarata publike që do të konsultohet opozita, mirëpo në praktikë është vepruar ndryshe. Mendoj se qëndrimi i partive opozitare është në përputhje me mandatin që kanë partitë opozitare", ka thënë

ai. Edhe analisti tjetër politik Faton Abdullahu ka deklaruar për "Epokën e re" se me përçarje të spektrit politik humbet Kosova. "Po vazhdojmë të mos jemi unikë si në këtë qeveri, si në atë para kësaj, edhe përkundër faktit se po bindemi pandalshëm sa agresive, por edhe e bashkuar është Serbia kundër nesh. Sa më të përçarë aq më shumë do të zvogëlohen mundësitë që të përfitojmë ndonjë gjë nga dialogu me Serbinë. E pakuptueshme prej nga kjo prirje noshalante për të mos u bërë bashkë së paku në

përballje me Serbinë. Të përçarëve nuk u ndihmon as Zoti e as Amerika. Shqiptarëve u është rikthyer një e metë e vjetër ku, inati po u bëhet më i madh se arsyeja e ky inat u vjen si duket nga grykësia për të shukur sa më shumë pushtet. Nuk shpresoj shumë se kjo do të tejkalohet lehtë ndërmjet partnerëve të koalicionit aktual", ka thënë Abdullahu. Ai ka vlerësuar se për takime të tilla të rëndësishme Kosova duhet të flasë me një zë. "Më 4 shtator në Uashington do të vihen në vija të trasha synimet dhe qëllimet e një projekti ekonomik i cili nuk mund

të jetë vetëm ekonomik por, në një të ardhme të afërt, do ta marrë edhe dimensionin politik. Shpresoj shumë se ato që i mungojnë qeverisë Hoti, e ato janë mangësi të shumta, do të kompensohen nga ndihma dhe përkujdesja e partnerit tonë, në këtë rast Uashingtonit zyrtar", është shprehur Avdullahu.

LV-ja dhe PDK-ja me qëndrime të ndryshme për takimin e Uashingtonit

Subjektet politike opozitare

Diskutohet për shtesat në pagë për punonjësit shëndetësorë

Palët u pajtuan që t'i vazhdojnë përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje, me qëllim që në lista të përfshihen të gjithë punëtorët shëndetësorë dhe stafi mbështetës, të angazhuar gjatë kohës së pandemisë Covid-19

PRISHTINË, 31 GUSHT - Të hënën u realizua një takim i përbashkët mes ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj, ushtruesit të detyrës së drejtorit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar, Valbon Krasniqi, dhe nënkryetarit të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë në Kosovë, Xhemajl Selmani, ku u diskutua përkritazi me çështjen për shtesën në paga për muajt korrik dhe gusht për punëtorët shëndetësorë dhe stafin mbështetës.

Palët u pajtuan që t'i vazhdojnë përpjekjet për gjetjen e një zgjidhjeje, me qëllim që në lista të përfshihen të gjithë punëtorët shëndetësorë dhe stafi mbështetës, të angazhuar gjatë kohës së pandemisë Covid-19. Menaxhmenti i ShSKUK-së dhe Ministria e Shëndetësisë do të punojnë intensivisht në koordinim me Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë për t'i përfshirë në listat për shtesën në paga të gjithë, pa dallim, përkundër buxhetit të limituar.



NË UASHINGTON PA OPOZITËN



kanë refuzuar ftesën e kryeministrit për pjesëmarrje në delegacion për takimin e Uashingtonit për arsye të ndryshme. Lëvizja Vetëvendosje është shprehur skeptike për takimin e 4 shtatorit dhe ka akuzuar qeverinë për moslegjitimitet, ndërsa PDK-ja e ka mirëpritur takimin e Uashingtonit, por e ka kritikuar qasjen e kryeministrit Hoti në këtë proces.

Lideri i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se me këtë qeveri Kosova është e dobët në këtë proces. "Problem për ne është edhe

pjesëmarrja në një takim me një kryeministër i cili nuk gëzon as legjitimitet demokratik e as autoritet popullor, e i cili pretendon se kështu i dobët të shkojë të negociojë për Kosovën. Dobësia e tij do të shndërrohet në dobësi të Kosovës nëse nuk veprojmë ashtu siç duhet e nëse procesin nuk e udhëheq subjekti e personi që fiton zgjedhjet e lira dhe demokratike që duhet të mbahen sa më shpejt", ka vlerësuar Kurti.

Ndërsa kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, nëpërmjet një letre ka rikonfirmuar qëndrimin zyrtar

të PDK-së, se mbështet angazhimin e ShBA-së dhe të BE-së në procesin e dialogut si partnerë strategjik ndërkombëtar, por kjo parti nuk do të jetë pjesë e delegacionit të Kosovës.

Veseli ka thënë se PDK-ja do ta ushtrojë rolin kushtetues në procesin e dialogut, si opozitë në Kuvendin e Kosovës. "Partia Demokratike e Kosovës do ta ushtrojë rolin e saj kushtetues në procesin e dialogut si opozitë në Kuvendin e Kosovës, por nuk do të jetë pjesë e delegacionit. Partia Demokratike e Kosovës

mbështet vetëm një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare që është në përputhje me platformën tashmë të njohur të saj, e cila garanton njohjen e ndërsjellë, sovranitetin shtetëror, integritetin territorial, karakterin unitar të shtetit dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB", ka vlerësuar Veseli.

Të premtën delegacioni i Kosovës dhe ai i Serbisë pritet të takohen në Shtëpinë e Bardhë me ftesën që ua kanë bërë këshilltari për Siguri Kombëtare i presidentit Trump, Robert

O'Brein, dhe i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për bisedimet Kosovë - Serbi, Richard Grenell.

Pjesë e ekipit të delegacionit të Kosovës, përveç kryeministrit Avdullah Hoti dhe koordinatorshtetëror Skender Hyseni, do të jenë dy zëvendëskryeministrit, Driton Selmanaj dhe Albulena Balaj-Halimi, dy ministrit nga radhët e AAK-së, Selim Selimi dhe Meliza Haradinaj-Stublla, si dhe ministri i Infrastrukturës, Abran Abrashi, dhe shefja e kabinetit të kryeministrit Hoti, Ardita Dushi.

Reçica u kërkon komisioneve të KES-it të punojnë për pagën minimale dhe kontratën kolektive

PRISHTINË, 31 GUSHT (ER) - Nën kryesimin e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Këshillit Ekonomik-Social, ku nga anëtarët e pranishëm janë miratuar vendimet për konsolidimin e pesë komisioneve profesionale, për përbërjen e të cilave janë përfaqësues nga Qeveria e Republikës së Kosovës, organizatat e të punësuarve (sindikatat) dhe organizatat e punëdhënësve.

Menjëherë pas miratimit të këtyre komisioneve, ministri i MPMS-së, Skender Reçica, ka kërkuar nga Komisioni profe-

sional për financa, ekonomi dhe privatizim, që sa më parë ta fillojë punën për analizimin dhe sjelljen e propozimit profesional për pagën minimale në vend, për miratim në KES, për t'u proceduar pastaj për qeveri. Gjithashtu, ministri Reçica një kërkesë të tillë e ka adresuar edhe te Komisioni profesional për legjislacion, që ta nisë sa më parë punën për hartimin e kontratës kolektive në vend, e cila do të ishte e pranueshme për të gjitha palët, duke pasur për bazë edhe situatën pandemike dhe, para së gjithash, të jetë një kontratë e zbatueshme nga të gjitha palët.



Familjarët presin që rasti i vëllezërve Bytyqi të diskutohet në takimin Hoti - Vuçiq

PRISHTINË, 31 GUSHT - Familjarët të vëllezërve të vrarë Bytyqi presin që në takimin e Uashingtonit, midis kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, të diskutohet mënyra për zgjidhjen e rastit të vrasjes së Agron, Yll dhe Mehmet Bytyqit. "Një president që kryeson një takim midis Kosovës dhe Serbisë... është vërtet historike", thuhet në një deklaratë dërguar mediave nga Fatos dhe Ilir Bytyqi, vëllezërit e tre të vrarëve. "Duke i përfaqësuar amerikanët që janë viktimizuar jashtë vendit, presidenti Trump duhet ta ngrejë çështjen e vëllezërit Bytyqi", thanë ata.

Hoti dhe Vuçiq takohen në Uashington më 4 shtator.

Pjesëmarrja në takim e presidentit Trump nuk është konfirmuar, por një mundësi të tillë e ka përmendur Vuçiq.

Agron, Mehmet dhe Yll Bytyqi,



shtetas amerikanë, me prejardhje nga Kosova, janë arrestuar në vitin 1999 në Serbi për shkak të, siç kanë thënë zyrtarët serbë, kalimit të

paligjshëm të kufirit. Ata janë liruar nga burgu pasi janë dënuar dhe më pas janë vrarë. Trupat e tyre janë gjetur në një varr masiv, pranë Petrovo Sellos

në lindje të Serbisë në vitin 2001.

Dy policë të akuzuar për ndihmë në likuidimin e vëllezërve Bytyqi, Sreten

Popoviq dhe Millosh Stojanoviq, janë shpallur të pafajshëm me vendim të Gjykatës së Lartë në Beograd për krime lufte.

Gjykata ka thënë se nuk ka prova për përfshirjen e tyre në vrasjet e kryera në korrik të vitit 1999. Një rezolutë e miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve e Shteteve të Bashkuara, në tetor të vitit të kaluar, u referohet fakteve për përfshirje në vrasje edhe të ish-zëvendësministrit të Brendshëm të Serbisë, Vllastimir Gjorgjeviq, dhe të ish-komandantit të xhandarmërisë serbe, Goran Radosavleviq Guri. Në deklaratën e vëllezërve Bytyqi thuhet se ata e mbështesin një marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë që do t'i çonte dy vendet drejt paqes së qëndrueshme.

Por, shtojnë ata, përparimi i tillë mund të arrihet vetëm duke i adresuar të gjitha çështjet e vështira, përfshirë rastin e vëllezërve Bytyqi.

93 për qind e fëmijëve në Kosovë kanë smartphone

Për herë të parë në Kosovë është realizuar një hulumtim shkencor për kohën e qëndrimit online të fëmijëve në internet. Bazuar në gjetjet e hulumtimit, të cilat kanë dalë nga pyetësori i standardizuar i studiueses Sonia Livingstone, në të gjitha vendet evropiane dhe më gjerë, e ku grupmosha e përfshirë në këtë hulumtim iu përket fëmijëve të moshës 11-16 vjeç, del se në Kosovë 93 për qind e fëmijëve të kësaj grupmoshe kanë deklaruar se kanë smartphone

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 GUSHT - Për herë të parë në Kosovë është realizuar një hulumtim shkencor për kohën e qëndrimit online të fëmijëve, përvojat dhe rreziqet e tyre nga të qenit i pranishëm në internet.

Projekti është realizuar nga Kolegji AAB në kuadër të granteve shkencore të ndara nga MASH-i për projekte shkencore. Që nga viti 2009 studime të tilla për fëmijët në vendet e BE-së realizohen vazhdimisht, ndërsa në vendin tonë ky projekt është realizuar për herë të parë, përderisa vendet e rajonit si Serbia është e përfshirë në këto të dhëna, ndërsa Shqipëria mbetet në proces.

Në prezantimin e rezultateve të hulumtimit të realizuar gjatë vitit 2009, prorektori për hulumtim shkencor në Kolegjin AAB, Hasan Saliu, ka theksuar se për shkak të rrethanave me pandeminë nuk kanë mundur ta prezantojnë më herët. "Qëllimi i

këtij hulumtimi ka qenë që të matet koha e qëndrimit online të fëmijëve, për çka e përdorin ata dhe cilët janë rreziqet që mund t'iu kanosen atyre. Objektivi tjetër është se çfarë i dallon fëmijët në Kosovë dhe ata në Evropë", ka thënë Saliu.

Ai bëri me dije se konsulent profesional në këtë projekt ka qenë Universiteti i Peruxhas nga Italia, ndërsa të dhënat preliminare janë prezantuar në konferencën më të madhe të komunikimit dhe mediave në Universitetin Complutense të Madridit.

Bazuar në gjetjet e hulumtimit, të cilat kanë dalë nga pyetësori i standardizuar sipas studiueses Sonia Livingstone, në të gjitha vendet evropiane dhe më gjerë, e ku grupmosha e përfshirë në këtë hulumtim iu përket fëmijëve të moshës 11-16 vjeç, del se në Kosovë 93 për qind e fëmijëve të kësaj grupmoshe kanë deklaruar se kanë smartphone. Kjo edhe nxjerr të dhënat e qasjes së tyre në internet, ku burimi kryesor i

qasjes është telefoni mobil (88 për qind), i pasuar nga laptopi personal (82 për qind). "Gjetjet e hulumtimit tregojnë se fëmijët kosovarë gjatë fundjavës dhe pushimeve verore dyfishojnë kohën e qëndrimit në internet krahasuar me kohën gjatë ditëve të mesimit. Rreth 40 për qind e tyre gjatë fundjavës theksojnë se harxhojnë deri 3-4 orë në ditë online gjatë fundjavës, përderisa gjatë ditëve të mesimit ata janë online 1-2 orë", ka theksuar Zija Rexhepi, profesor në Kolegjin AAB.

Të dhënat tregojnë se mbi 60 për qind e fëmijëve të grupmoshës 11-16 vjeç në Kosovë në baza ditore shikojnë videoklipe dhe dëgjojnë muzikë në youtube, ndërsa mbi 72,5 për qind e tyre çdo ditë janë të pranishëm në rrjete sociale.

Në këtë pikë janë fëmijët e gjinisë mashkullore që dominojnë me prani në rrjete sociale (80 për qind) kundrejt vajzave (77.5 për qind).


Rrjetet sociale më të popullarizuara të kësaj grupmoshe mbeten 'Instagram'-i (43 për qind) dhe 'Facebook' (23 për qind). Duke folur për përvojat e fëmijëve, bazuar në gjetjet e hulumtimit, profesoresha Saranda Shatri tregoi se 27.2 për qind janë shprehur se e kanë më lehtë të bisedojnë disa gjëra online të cilat, përndryshe, nuk do t'i bisedonin me dikë ballë për ballë.

Shqetësues janë edhe rezultatet e dala për konsumimin e përmbajtjeve seksuale online

nga fëmijët e moshës 11-16 vjeç. 18.5 për qind kanë deklaruar se kanë parë imazhe, fotografi, vizatime apo video të ndryshme me pamje seksuale. Prej këtyre, 7.8 për qind kanë thënë se këto imazhe i shohin çdo ditë apo gati çdo ditë. Djemtë janë konsumatorë më të mëdhenj të këtyre përmbajtjeve dhe më pak të shqetësuar se vajzat (40,5 për qind e tyre deklarohen se nuk shqetësohen fare për përmbajtjen).

Profesoresha Mimoza Kamberi ka treguar se në bazë të gjetjeve të hulumtimit, del se 30 për qind e respondentëve kanë diskutuar me prindërit për këto çështje,

përderisa 70 për qind e tyre nuk i kanë diskutuar fare. Megjithatë, krahasuar me vendet e tjera, konsumimi i këtyre përmbajtjeve eksplicite në Kosovë mbetet më i ulët se në vendet e tjera (p. sh., Francë, 21 për qind, Serbi, 50 për qind etj.). Duke u bazuar në këto të dhëna, autorët e hulumtimit rekomandojnë që në arsimimin parauniversitar medoemos duhet të futet lënda "Edukim Mediatik", me një kurrikulë të qëndrueshme dhe të përditësuar. Po ashtu, një rol të rëndësishëm e ka sensibilizimi i ndërmjetësimit prindëror në këtë aspekt.



Për periudhën gjashtëmujore, kryetarët e komunave përmbushën 364 premtime

Instituti GAP ka publikuar në platformën elektronike "Letërnjoftimi i Komunave" të dhënat më të fundit për realizimin e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2017-s. Periudha e monitorimit përfshin gjashtëmujorin e parë të 2020-s. Nga gjithsej 903 premtime të evidentuara nga Instituti GAP, deri në muajin qershor 2020 janë përmbushur 364 premtime. Në pjesën më të madhe të periudhës së gjashtëmujorit të parë të këtij viti komunat janë përballur me gjendje të rënduar si pasojë e pandemisë Covid-19

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 GUSHT - Instituti GAP ka publikuar në platformën elektronike "Letërnjoftimi i Komunave" të dhënat më të fundit për realizimin e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të 2017-s. Periudha e monitorimit përfshin gjashtëmujorin e parë të 2020-s.

Nga gjithsej 903 premtime të evidentuara nga Instituti GAP, deri në muajin qershor 2020 janë përmbushur 364 premtime, 185 premtime janë realizuar pjesërisht, 206 premtime kanë filluar të përmbushen, ndërsa për 148 premtime nuk është evi-

dentuar ndonjë nismë për përmbushjen e tyre.

Numri më i madh i premtimeve është realizuar në fushën e çështjeve sociale (74 për qind), fushën e bujqësisë (57 për qind) dhe atë të administratës (53 për qind). Ndërsa shkalla më e ulët e përmbushjes së premtimeve është shënuar në fushën e kulturës (28 për qind) dhe atë të urbanizimit (22 për qind).

Në pjesën më të madhe të periudhës së gjashtëmujorit të parë të këtij viti komunat janë përballur me gjendje të rënduar si pasojë e pandemisë Covid-19. Përkundër kësaj, rezultatet e dala nga vlerësimi i përmbushjes së premtimeve tregojnë për

një performancë të mirë të pushtetit lokal në përmbushjen e planeve dhe projekteve të parapara.

Instituti GAP bën monitorimin e përmbushjes së premtimeve në 26 nga 38 komunat ngaqë 12 nga kryetarët aktualë nuk kanë zhvilluar fushatë zgjedhore (Skenderaj, Mamusha dhe komunat me shumicë serbe).

Përmes vlerësimit të premtimeve zgjedhore, Instituti GAP ka për qëllim që t'i mbajë të përgjegjshëm kryetarët e zgjedhur për premtimet e dhëna. Vlerësimi i premtimeve bëhet në mënyrë periodike përmes bashkëpunimit me organizatat lokale.

Niveli i përmbushjes së premtimeve nga 26 komunat e Kosovës deri në muajin qershor 2020

364 të përmbushura 40%
185 pjesërisht të përmbushura 21%
206 të filluara 23%
148 nuk kanë filluar 16%

Premtimet e dhëna sipas fushave dhe niveli i përmbushjes



Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve për EULEX-in, i ulët

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar të hënën raportin me titull 'Legjitimimi i misioneve të huaja: Dekonstruktimi i perceptimeve të qytetarëve ndaj EULEX-it në Kosovë'. Qëllimi kryesor i raportit është përdorimi i provave empirike të perceptimit të qytetarëve që kanë të bëjnë me nivelet e kënaqshmërisë ndaj EULEX-it. Barometri i Sigurisë së Kosovës (BKS) ka matur kënaqësinë e qytetarëve ndaj të EULEX-it për vitet 2012-2018. Sipas këtij raporti, niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve për EULEX-in mbetet i ulët

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 GUSHT - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar të hënën raportin me titull 'Legjitimimi i misioneve të huaja: Dekonstruktimi i perceptimeve të qytetarëve ndaj EULEX-it në Kosovë', me autore Emma-Louise Rose.

Qëllimi kryesor i raportit është përdorimi i provave empirike të perceptimit të qytetarëve që kanë të bëjnë me nivelet e kënaqshmërisë ndaj EULEX-it. Qëllimi i misionit të EULEX-it ishte ndërtimi dhe përmirësimi i institucioneve të shtetit të së drejtës në vend. Ai e ka zgjatur mandatin e tij disa herë, me ndryshime të ndryshme të personelit dhe rishtrukturime, me mandatin aktual që duhet të skadojë më

2021.

Barometri i Sigurisë së Kosovës (BKS) ka matur kënaqësinë e qytetarëve ndaj EULEX-it për vitet 2012-2018. Këto të dhëna nga BKS formojnë një bazë të rëndësishme për këtë përmbledhje e cila përdor të dhënat e BKS-së për të analizuar nëse dhe si nivelet e kënaqësisë kanë ndryshuar me kalimin e kohës, mbështetur nga hulumtimet e tjera përkatëse si nga individët ashtu edhe nga organizatat.

Kjo përmbledhje gjeti se, pavarësisht se EULEX-i ishte misioni civil më i madh i BE-së ndonjëherë, në sytë e publikut të Kosovës ai ka arritur shumë pak që nga fillimi i misionit në vitin 2008. Gjatë gjithë viteve që u matën, kënaqësia mbeti e ulët me arsyetimet e lidhura me një dështim për t'i kryer qëllimet e tij dhe skandalet e



shumta që kanë ndodhur gjatë pranisë së tij në Kosovë të cilat përfshijnë thashetheme për korrupsion dhe ndërhyrje politike, si dhe një dështim për të ndjekur penalisht individë të shumtë. Për më tepër, shumica e të anketuarve nga BKS menduan se koha e misionit në Kosovë duhet të ishte e kufizuar. Megjithatë ka pasur disa 'kulme'

të niveleve më të larta të kënaqësisë, ai kurrë nuk u rrit mbi 31.4 për qind në fund të 2013-s që sjell legjitimitetin e misionit në pikëpyetje. Mungesa e suksesit për misionin mund të shihet duke përdorur masa të tilla si Indeksi i Transparencës, i cili tregon nivele të ulëta të përmirësimit në lidhje me korrupsionin në

përgjithësi në Kosovë - diçka që u reflektua edhe në BKS. Për më tepër, përmbledhja zbuloi se, krahasuar me misionet e tjera ndërkombëtare të pranishme në Kosovë siç është KFOR, EULEX-i ka nivele shumë të ulëta të kontaktit me publikun e Kosovës dhe ku ka pasur kontakt, cilësia e kontaktit ishte e pamjaftueshme.

Zgjatet afati për aplikim për Programin e Vetëpunësimit për personat e riatdhesuar

PRISHTINË, 31 GUSHT (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka njoftuar për zgjatjen e afatit për aplikim për Programin e Vetëpunësimit për personat e riatdhesuar. Sipas MPMS-së, me qëllim të ofrimit të mbështetjes për personat e riatdhesuar në Kosovë, për realizimin e planeve të tyre të biznesit, dhe si përpjekje e shtuar për ta ndihmuar rimëkëmbjen ekonomike gjatë përbaljes me pandeminë Covid-19, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK), në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), me

mbështetje nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR), zgjasin afatin e thirrjes për aplikim për Programin e Vetëpunësimit për personat e riatdhesuar deri më datë 16 shtator 2020.

Qëllimi i Programit të Vetëpunësimit është t'i mbështesë personat e riatdhesuar të regjistruar të papunë për krijimin e planeve të realizueshme të biznesit që janë në gjendje t'i mbijetojnë tregut konkurrues duke promovuar vetëpunësimin si masë aktive e tregut të punës. Mbështetja me grante do të ofrojë mjete/pajisje teknike për realizimin e planit të biznesit.



Banka Botërore pezullon raportin 'Doing Business', shkak parregullsia e të dhënave



Prishtinë, 31 gusht - Banka Botërore ka pezulluar botimin e indeksit të saj botëror të klimës së biznesit, pasi ka identifikuar "parregullsi" në të dhënat e saj, që mund të kenë ndikuar në renditjen e katër vendeve. Raporti vjetor 'Doing Business', i nisur në vitin 2002, është bërë një matës me ndikim për ta vlerësuar mjedisin e biznesit dhe

konkurrencën relative të vendeve. "Një numër i parregullsive janë raportuar në lidhje me ndryshimet në të dhënat në raportet 'Doing Business 2018' dhe 'Doing Business 2020', të botuara në muajin tetor 2017 dhe 2019. Ndryshimet në të dhënat nuk ishin në përputhje me metodologjinë e 'Doing Business'. Ne do të veprojme

bazuar në gjetjet dhe do t'i korrigjojmë përkatësisht të dhënat e vendeve që ishin më të prekura nga parregullsitë", thuhet në njoftimin e Bankës Botërore. Sipas raportit të fundit, Kosova radhitet në pozitën e 57-të nga 190 vende sa i përket lehtësisë së të bërit biznes, krahasuar me vendin e 44-t ku ka qenë vitin e kaluar.



Punëtorët e Telekomit marrin pagat për muajin gusht

PRISHTINË, 31 GUSHT (ER) - Punonjësit e Telekomit të Kosovës të hënë kanë marrë pagat për muajin gusht. Kjo u bë me dije nga vetë të punësuarit në këtë

ndërmarrje publike. Pas shumë muajsh, qëkur u shfaqën probleme të theksuara financiare, ka pasur vonesa disajvëshe për ekzekutimin e pagesave. Kjo është

hera e parë që menaxhmenti i ri arriti t'i ekzekutojë pagat në kohën e duhur, saktësisht ditën e fundit të muajit. Siç dihet, pas bllokimit dhe

tërheqjes së mjeteve nga 'Z-mobile' dhe zhbllokimit të xhironlogarive, me ndërhyrjen e Qeverisë së Kosovës situata financiare në këtë ndërmarrje

është vështirësuar, mirëpo qasja e menaxhmentit aktual së bashku me Bordin e Drejtorëve duket se po jep rezultate të stabilitetit financiar.

Ndërmerren të gjitha masat për zgjerimin e mihjes ekzistuese të Sibovcit Jug-Perëndimor

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, së bashku me Korporatën Energjetike të Kosovës, kanë ndërmarrë të gjitha masat për realizimin e investimeve për zgjerimin e mihjes ekzistuese të Sibovcit Jug-Perëndimor

EPOKA ERE Albulena S. MARVAJ

PRISHTINË, 31 GUSHT - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka thënë se me zgjerimin e mihjes Kosova do ta ketë më të sigurt prodhimin e energjisë në njërin anë dhe në anën tjetër do të bëhet një zgjidhje e pranueshme edhe për banorët që do të afektohen nga ky investim. "Ne si ministri kemi objektiv përkrahjen e KEK-ut që t'i vazhdojë hapat dhe procedurat për investime për zgjerimin e mihjes, pasi thëngjilli mbetet lënda kryesore për prodhimin e energjisë në vendin tonë. Në rastin konkret, brenda kompetencave tona kemi aprovuar Planin e Veprimit të Zhvendosjes për zonën e fundit të mihjes Sibovci Jug-Perëndim, që do t'i mundësojë KEK-ut vazhdimësi në furnizimin me qymyr për një periudhë afatmesme. Gjithashtu, kam kërkuar nga KEK-u që të bashkëpunojë ngushtë me banorët, në mënyrë që i gjithë procesi të kryhet pa probleme. Ministria që drejtoj e ka në fokus kryesor marrjen e të gjitha masave për

të pasur furnizim të sigurt me energji, por edhe në anën tjetër të sigurohemi që i gjithë procesi të jetë transparent dhe i pranueshëm për të gjithë, ku banorët e afektuar janë palë kyçe, duke u bazuar në ligjet që janë në fuqi", ka deklaruar ministri Kuçi. Ministri Kuçi ka bërë me dije se qeveria është plotësisht e angazhuar për realizimin e plotë të strategjisë nacionale të qeverisë për sektorin energjisë.

Ndërkaq ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv, Luigj Imeri, ka treguar për veprimet e deritanishme të ndërmarrë nga KEK-u për ta realizuar me sukses këtë projekt. "Korporata Energjetike mbi bazën e përgjegjësisë dhe në planifikimet e veta strategjike, bazuar edhe në vendimet e qeverisë për zgjerim të minierës, faktikisht ka ndjekur të gjitha procedurat juridiko-ligjore, të cilat e bëjnë të mundur shpronësimin e pronave të asaj zone. Ajo është zonë prej 129 hektarëve, e cila ka për qëllim sigurimin e prodhimit të energjisë nga qymyri deri në vitin 2027, eventualisht viti 2030. Në anën tjetër, ia ka dërguar Ministrisë



së Ekonomisë dhe Ambientit për aprovim planin e zhvendosjes dhe kjo ministri kompetente e ka aprovuar këtë plan dhe na ka hapur rrugën për t'i vazhduar procedurat e tjera që janë adekuate administrative, dhe në ditët në vijim pritet që korporata të fillojë t'ua dorëzojë pronarëve pakot të cilat janë hartuar nga kompania e specializuar, të përfshira me të gjithë komponentët dhe vlerësimet e duhura në të, kështu që ne po shpresojmë që gjatë ditëve në vijim do të jetë një proces, i cili do t'i hapë rrugë më pas funksionimit tonë normal", u shpreh Imeri.

Imeri, po ashtu, ka bërë me dije

se deri më tani KEK-u ka zhvilluar diskutime me banorët e zonës Hade, Sibovc, Palaj, Leshkoshiq dhe Shipitullë që do të preken nga ky projekt. "Për fat të mirë, ne në vitin 2020 kemi buxhetin e mjaftueshëm për t'u futur me garanci në marrëveshje me banorët sepse ajo që është kryesorja, është se duhet të kemi mjete. Këtë e kemi siguruar, kështu që mbetet fazë teknike për përmbylljen e saj. Më lejoni t'i falënderoj të gjithë aktorët që kanë qenë të angazhuar për realizimin e këtij objekti që është kaq i rëndësishëm për korporatën që deri sot nuk është hasur në asnjë lloj pengese sipas planit të

paraparë dhe po shpresojmë që edhe faza e fundit përmbyllëse do të shkojë ashtu siç ne e kemi projektin. Vlen të theksohet se Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit në një afat shumë të shkurtër ka arritur që të aprovojë kërkesën tonë për planin e zhvendosjes, kështu që kjo nënkupton edhe vlerësimin e punës që njerëzit kompetentë që janë marrë me këtë punë, të cilët kanë arritur ta kryejnë në afatin shumë të shkurtër", tha tutje ai.

Sipas projektit kryesor xehetar, kjo zonë është pjesa e fundit e të ashtuquajturës mihje Sibovc Jug-Perëndim, që parashihet të ketë një kapacitet mesatar deri në 9 milionë tonë në vit.

Fermerët e Rahovecit që janë dëmtuar nga breshri dhe vërshimet kërkojnë që t'u bëhen pagesat

RAHOVEC, 31 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka zhvilluar një takim me përfaqësues të fermerëve të dëmtuar nga breshri dhe vërshimet që ndodhën gjatë muajit maj në këtë komunë. Arsyeja e këtyre fermerëve që ai kishin mësyre Komunës së Rahovecit ishte për ta shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj vonesave të qeverisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, në ekzekutimin e 25 për qind të vlerës së dëmit të shkaktuar nga breshri dhe vërshimet. "Qeveria më 5 korrik ka ndarë mbi 1.8 milion euro për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë bujqësore nga fatkeqësitë natyrore, e ndër komunat përfituese është edhe

Komuna e Rahovecit, në shumën: 660,275.00 euro. Ne si komunë kemi përfunduar të gjitha procedurat e kërkuara nga ana e ministrisë për kompensimin e fermerëve tanë, andaj presim që Qeveria e Republikës së Kosovës të reflektojë dhe sa më shpejt ta ekzekutojë vendimin për dëmshpërblim të fermerëve të kësaj treve, ku bujqësia zë vendin kryesor", ka thënë Latifi. Ai ka theksuar se mirëpresin çdo vendim në dobi të fermerëve të Komunës së Rahovecit. "Kërkojmë të kryhet procesi i ekzekutimit të pagesave për kompensimin e dëmeve. Vonesat po e rëndojnë gjendjen edhe më shumë", ka deklaruar kryetari Latifi.



Muhaxheri me Këshillin e Drejtorëve diskuton për fillimin e vitit të ri shkollor

PEJË, 31 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, ka udhëhequr të hënën takimin konsultativ të Këshillit të Drejtorëve, ku është diskutuar për takimin e rregullt të Kuvendit Komunal të Pejës, për provimin e maturës shtetërore 2020, për fillimin e vitit të ri shkollor, për aktivitetet e prokurimit dhe për punët të cilat janë në përfundim e sipër. Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Pejës, Islam Husaj, ka bërë me

dije se kanë përfunduar dëgjimet publike për hartimin e buxhetit 2021. Ai ka thënë se në muajin shtator në planin e punës së Kuvendit kanë edhe rregulloren për tatim në pronë dhe taksa e tarifa. Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, Besim Avdimetaj, i ka njoftuar të pranishmit për mbajtjen e provimit të maturës shtetërore 2020, i cili është organizuar duke i respektuar masat mbrojtëse të rekomanduara

nga institucionet e shëndetësisë. Avdimetaj ka thënë se në bazë të udhëzuesit për fillimin e vitit të ri shkollor aty thuhet se shkollat duhet të krijojnë task forca. Sipas tij, shkollat e fshatit kanë qenë të gatshme për fillimin e vitit të ri shkollor. "Kemi qenë të përgatitur për të filluar që nesër mësimi, por problem janë shkollat të cilat kanë numër më të madh të nxënësve", ka thënë ai.



Vlerësohet raporti gjashtëmujor i punës së kryetarit Lladrovci

Drenas, 31 gusht (ER) - Kuvendi i Komunës së Drenasit ka mbajtur mbledhjen e rregullt, në të cilën kanë marrë pjesë kryetari Ramiz Lladrovci, nënkryetari Nazmi Hasi, kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, asamblistë dhe drejtorë të drejtorive komunale. Në këtë mbledhje është diskutuar raporti i punës së kryetarit Lladrovci për periudhën janar-qershor 2020, ku është vlerësuar lart ky raport, pasi që nuk është zhvilluar asnjë debat lidhur me punën gjashtëmujore të kryetarit Lladrovci. Sipas kësaj komune, propozim-vendimi për miratimin paraprak të vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit në shfrytëzim afatgjatë personave fizikë/juridikë është votuar me vota unanime. "Në pikën të ndryshme janë diskutuar çështje të ndryshme dhe i janë bërë pyetje ekzekutiv



dhe kanë marrë përgjigje me secilën çështje të ngritur. Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19 dhe zbatimit të rekomandimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës është mbajtur në Sallën e Kulturës

dhe nuk janë krijuar kushtet që mbledhja të transmetohet online përmes uebfaqes së komunës dhe kanalit zyrtar YouTube, megjithatë mbledhja është në audio-ncizim. Salla e Kulturës është dezinfektuar para se të mbahet takimi i Kuvendit", ka njoftuar Komuna e Drenasit.

Sot fillon punën çerdhja publike në qytetin e Lipjanit

Lipjan, 31 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, të hënën ka mbajtur mbledhjen e rregullt me drejtorët e drejtorive komunale, ku është raportuar për rezultatet e punës javore si dhe për menaxhimin e përgjithshëm në drejtoritë përkatëse. Kryetari Ahmeti ka kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që për çdo projekt të realizuar për asfaltim në qytet dhe në fshatra, aty ku është nevoja, t'u mundësohet qasja në rrugë të gjithë personave me nevoja të veçanta. Po ashtu, kryetari Ahmeti gjatë kësaj mbledhje ka

kërkuar nga të gjithë drejtorët përshpejtimin e përgatitjes së procedurave për furnizime dhe punë sipas kërkesave të departamenteve, në veçanti shërbimet publike, arsimit dhe shëndetësia. Gjithashtu, ai kërkoj nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Kulturës që të zhvillojnë procedurat e nevojshme për subvencionimin e bujqësisë dhe DKRS për subvencionimin e klubeve sportive, aktiviteteve rinore dhe kulturore etj. Me vendim të kryetarit të komunës, nga 1 shtatori do ta fillojë punën çerdhja publike në qytetin e Lipjanit.



Haziri viziton QKMF-në, konfirmon mbështetjen për përballimin e pandemisë

GJILAN, 31 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vizituar të hënën Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, për t'i uruar detyrën e re drejtoreshës Arbenita Hajdari dhe mbarë stafit për menaxhimin e vazhdueshëm të të gjitha QMF-ve në përballje me pandeminë dhe me të gjitha shërbimet që ofron shëndetësia primare për qytetarët. "Besoj shumë në profesionalizmin e drejtoreshës dhe të stafit të QKMF-së në përgjithësi, por e nevojshme është mbështetja e disa projekteve që do ta bënin edhe më të lehtë punën gjatë të ardhmes. Shumë shpejt do të

fillojë bartja e stafit në spitalin e ri, një objekt modern që po shkon drejt finalizimit, ku do të pajisen edhe me mjete moderne të punës, në mënyrë që angazhimet të jenë në funksion të punës dhe rritjes së efikasitetit ndaj pacientëve. Në këtë fazë ka shumë detyra dhe obligime që duhet të menaxhohen në mënyrë më të mirë të mundshme, sepse është fillimi i vitit shkollor, janë vaksinimet, përballja me pandeminë dhe detyra të tjera që lidhen direkt me këtë qendër", ka thënë kryetari Haziri. Arbenita Hajdari, drejtoreshë e QKMF-së, e ka falënderuar

kryetarin për vizitën dhe lajmet e mira që ka sjellë në qendër e që, sipas saj, janë një lehtësi e madhe në punën dhe angazhimin e nivelit primar të shëndetësisë. "Mbështetja dhe bashkëpunimi i ofruar nga kryetari Haziri janë një nxitje edhe më e madhe për të gjithë ne, që të punojmë edhe më shumë në shërbim të qytetarëve në përgjithësi dhe pacientëve edhe përkundër që jemi në një kohë të vështirë të përballjes me pandeminë globale", ka thënë ajo. Ndërsa Selami Xhemajli, drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka potencuar se janë të fokusuar që së bashku ta



menaxhojnë realizimin e programit në shëndetësinë primare, të fokusuar në kushte më të mira për stafin dhe

kujdesin më të mirë për pacientët sepse, siç ka thënë ai, kjo është dera e parë ku qytetari kërkon ndihmën e mjekut.

NË ZONËN E CAHANIT NUK KA PASUR LËVIZJE NGA JASHTË BRENDË SHQIPËRISË (41)



Shkruan: Kudus LAMA

Pika 114 thotë: “Elementët e provës të mbledhur me rastin e këtyre procedurave duket që tregojnë se këta veprimtarë të UÇK-së si dhe komandanti i tyre rajonal i Veriut të Shqipërisë, Xheladin Gashi, sot i vdekur, ishin të afërt të “Grupit të Drenicës” drejtuar nga Hashim Thaçi dhe vepronin konkretisht së bashku me Kadri Veselin”. Deklarim ky që më bind plotësisht për pavërtetësinë dhe mashtrimin e qëllimshëm që ju bëni në këtë raport. Xheladin Gashi (Plaku) ka qenë një personalitet dhe asnjë shpifje nuk zë vend në portretin e tij sado e fuqishme të jetë. Ai nuk ka qenë një njeri që ju mund të thoni çfarë të doni për të, por një intelektual që ju s’keni për të arritur kurrë në nivelin e tij; një atdhetar i përkushtuar, një njeri me ndershmërinë më të lartë të mundshme, një njeri i drejtë dhe shumë i dashur me njerëzit, një komandant me karakteristikat më të spikatura të një komandanti ushtarak në situatë luftarake; një trim që nuk i trembej syri nga asnjë vështirësi, pengesë e as nga armët dhe ushtarët e armikut; një njeri i komunikueshëm dhe shumë i saktë në ato që thoshte dhe në ato që bënte; njëri nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që kishte marrë mbi vete barrë të rëndë në kushtet e asaj ushtrie, siç ishte mbështetja logjistike, por edhe organizimi i stërvitjes së ushtarëve e përcjellja e tyre për në front; kurrë nuk i ka interesuar të merret me vogëlsira, siç mund të jetë arrestimi apo marrja në pyetje e një të burgosuri edhe po të kishte të tillë, sepse ai ishte njeri i madh e merrej vetëm me gjëra të mëdha. E me Kadri Veselin gjatë vitit 1999 deri në qershor nuk besoj se janë takuar, pasi jo vetëm detyrat i kanë pasur të ndara e të veçanta, por edhe vendqëndrimet i kanë pasur larg njëri tjetrit. Nuk ishin në plazh ata, siç i imagjinoni ju e disa si ju ata djem e burra, por ishin në luftë dhe kishin një vendim në shpirtin dhe moralin e tyre: Të shpornnin armikun pushtues prej tokave të popullit të tyre, të çlironin përfundimisht atdheun. Për veprën që kanë bërë meritojnë gjithë respektin dhe lavdinë kombëtare, pavarësisht ju dhe atyre si ju që përpiqeni t’i njollosni dhe të ngarkoni mbi ta gjithçka që e keni në shpirtin tuaj.

Sepse psikologjikisht gjithë këto që keni shkruar ju në këtë raport, mund t’i shkruaj vetëm një njeri që psikikisht është i gatshëm t’i bëjë vetë. Askush nuk mund të shkruaj atë që nuk është i gatshëm ta bëjë vetë, e nisur nga kjo, ju më dukeni shumë i rrezikshëm zotëri Marty, të shpresoj që Evropa moderne të mos ketë shumë si ju.

Në pikën 115 ju detyrohemi të pranoni se: “Nuk gjetëm asnjë shenjë të transportimit të robërve nga Cahani drejt qendrës të tjera burgimi që ndodheshin në Shqipëri...” Por nga mllefi i madh që keni për dështimin edhe këtu nuk doni të kaloni në pikën tjetër pa paragjykuar, duke u shprehur: “...edhe pse kjo mundësi nuk mund të përjashtohet”. Jeni vërtetë i paskrupullt zotëri. Edhe kur nuk gjeni asgjë për ato që keni dëshirë dhe ambicie të gjeni, kërkoni të krijoni idenë tek të tjerët se ajo që keni zbuluar ju nuk është e saktë, pasi e vërteta është diçka tjetër, që ju keni dëshirë të jetë, ky është vërtetë një tregues i vogëlsisë së shpirtit tuaj, si përfaqësues i një institucioni të madh, siç është Këshilli i Evropës, në emër të të cilit veproni ju.

Njëkohësisht duhet të dini zotëri se në zonën e Cahanit nuk ka pasur lëvizje nga jashtë brenda Shqipërisë, sepse terreni në kufi ka qenë plotësisht i minuar nga forcat ushtarake serbe. Ndërsa për të kaluar nga jashtë brenda Kosovës, duhet të merreshin paraprakisht masat për të hapur shtigjet e nevojshme me specialistë të xhenios, pasi nuk duhet që luftëtarët që shkonin drejt frontit të binin në mina. Prandaj gjithçka që shkruani ju në pikën 117 më duket një përrallë e imagjinuar nga mendja juaj ose e atyre që ua kanë shkruar raportin. Ndërsa për dëshmitarët tuaj, që pretendoni që i keni, duhet të bëni ballafaqimin me personat që i akuzojnë, pasi akuzat në distancë unë mund të bëj për gjithkënd, nëse dikush më krijon favore, siç ua keni krijuar ju dhe Serbia atyre që iu dalin dëshmitarë të fshehtë. Si dëshmitar i fshehtë edhe unë mund të dal dëshmitar për ju e të them se ju keni qenë në vitin 1999 në Kukës dhe keni bërë shumë krime nga më monstruozet.

Pika 122, është një akuzë që ju e bëni ndaj shtetit shqiptar, duke e quajtur të pasaktë pohimin e tij se në territorin Republikës së Shqipërisë nuk është varrosur asnjë njeri i vrarë gjatë konfliktit në Kosovë. Mendoj se shteti shqiptar, duhet të jetë shprehur pak ndryshe, pasi në Shqipëri vërtetë janë varrosur luftëtarë të vrarë gjatë luftës në frontin e Koshares, të cilët janë varrosur në varrezat e Bajram Currit dhe një i vrarë në frontin e Pashtrikut i cili është varrosur në varrezat e

Kukësit. Por varrime të fshehta në Kukës nuk ka guxuar të bëjë njeri, pasi vetë populli do ta kishte marrë me dru gjithkënd që mund të tentonte të bënte një gjë të tillë. Mos harroni zotëri, Kukësi është i populluar me njerëz të kulturuar e nuk është shkretëtirë, siç keni dëshirë ta konsideroni ju.

Por ju nuk jeni i interesuar të gjeni të vdekur. Interesi juaj është që gjithçka shqiptare ta njollosësh. Nuk keni faj, këtë detyrë keni marrë nga padroni që iu paguan për këtë që bëni. Ju po nuk i gjetët të vrarët në tokë, do të thoni, siç thoni, janë në lumë, po nuk i gjetët në lumë, do të thoni janë në liqene, po nuk i gjetët në liqene, do të thoni se i kanë ngrënë njerëzit e gjallë, e nuk di çfarë mund të pjellë mendja juaj. Me rëndësi është që për të njollosur Kosovën, më parë duhet njollosur Shqipëria, kështu iu ka thënë padroni. Kryeni detyrën zotëri Marty.

Në këtë rrjedhë duke vazhduar arsyetimin tuaj, në pikën 124, ju deklaroni: “... ka dalë qartë tashmë se në disa raste të përcaktuara e të njohura, trupa Kosovare të vrarë janë varrosur në Shqipëri. Këto çështje kanë çuar – në raste të vërtetuara nga gazetarë shqiptarë e ndërkombëtarë, për të cilat jemi në dijeni – në bisedime të gjata por të matura midis familjeve të këtyre Kosovarëve dhe autoriteteve të ngarkuara për administrimin e kësaj varreze (këtyre varrezave) në Shqipëri. Është për t’u vënë në dukje në fund të fundit se në një rast që na është shpjeguar me hollësi nga një prej burimeve tona të drejtpërdrejta, trupat janë zhvarrosur dhe riatdhesuar në Kosovë për t’u varrosur sipas të gjitha rregullave nga familjet. Autoritetet shqiptare na kanë thënë se ato nuk kishin dijeni për çështje të kësaj natyre”. Duke iu referuar kësaj që ju trajtoni po i bëj pyetjen vetes: Si paska mundësi të ta vrasin kriminalisht familjarin dhe pastaj ta marrësh me ceremoni e ta varrosësh në varrezat e familjes? Këtë vërtetë zotëri Marty nuk e kuptoj, ndoshta ma sqaroni ju, pasi keni mashtruar me një tufë llafesh pa kuptim Këshillin e Europës. Është mirë t’i sqaroni këto arsytetime të pa arsyeshme. Nuk mund të lejoheni të shkoni me fjalë dhe vetëm me fjalë.

Burimet tuaja, që pretendoni se iu kanë thënë këto informacione duhet të dalin dhe të sqarohen publikun shqiptar e ndërkombëtar se si ka ndodhur në të vërtetë. Nëse ju të gjithë ata që kanë vdekur gjatë kohës që qytetarët e Kosovës qëndronin si të shpërngulur në Shqipëri, i konsideroni të mbytur e të vrarë nga UÇK-ja, duhet të thoni,

pretendimin tuaj dhe të arsyetoni, pasi realisht keni lëshuar mjegull, duke bërë me hije gjithë atë kohë krenarie për shqiptarët.

Në pikën 125, ju thoni: “...disa pohime përmendin ekzistencën e varreve masive në territorin shqiptar. Shërbimet e hetuesisë serbe të ngarkuara për krime lufte na kanë deklaruar se zotëronin fotografi të marra me satelit të zonave në të cilat ndodheshin këto varre; por vetë varret ende nuk janë gjetur gjë më sot, me gjithë kërkesën zyrtare për të bërë kërkime paraqitur nga autoritetet serbe pranë autoriteteve shqiptare”. Mirë që tregoni se informacionet i keni marrë në Serbi. Por nuk kuptoj me çfarë janë mbushur këto varreza masive. Sepse serb në Shqipëri të paktën publikisht nuk ka pasur, mund të ketë pasur vetëm ndonjë agjent të UDB-së, që nuk është evidentuar e që patjetër duhet të ketë raportuar për gjendjen në Shqipëri në atë periudhë, por ju siguroj se nëse ka folur për varreza masive, siç pretendoni ju, ka mashtruar, siç po mashtroni edhe ju gjithë botën me raportin tuaj, duke shfrytëzuar kartën e identitetit si parlamentar i Këshillit të Europës.

Njëkohësisht po më çudit fakti që Serbia paska satelitë për të zbuluar edhe varrezat masive, si ka mundësi që nuk po i tregon varrezat masive të rreth 2 mijë shqiptarëve edhe sot të zhdukur që i ka në territorin e saj? Ajo paska mundësi t’i dijë se ku janë, pasi kur ka pasur mundësi të fotografojë me satelitë Shqipërinë, dihet që në radhë të parë ka fotografuar Serbinë. Pse nuk ua kërkua këtë informacion zotëri Marty që të na bënit nder? Dhe njëkohësisht pse nuk ua dhanë ato fotografi që t’i shfrytëzonit edhe ju se do t’u dilte në i saktë raportit? Sa shakaxhi jeni në arsyetimet tuaja zotëri Marty.

Në pikat 129 e 130, ju filloni të nxirrni ide e të etiketoni krime të mundshme pas përfundimit të Luftës Çlirimtare të Kosovës. Mund të deklaroni çfarë të doni. Por kur në pikën 130 thoni: “Në muajt që pasuan menjëherë shpalljen e mbarimit të konfliktit në Kosovë në qershor 1999, anëtarë dhe simpatizantë të UÇK-së do kenë mbajtur në burgim të fshehtë në territorin shqiptar një numër të madh personash të rrëmbyer”. Më krijohet një shije e hidhur, për arsye se gjithë paragrafi i cituar është thjeshtë paragjykim keqdashës. Për këtë unë mund t’iu them ju dhe gjithë opinionit me përgjegjësi, se në zonën time të përgjegjësisë, pas datës 23 qershor, (kur Kosova

konsiderohej e lirë, se më 22 qershor ushtari i fundit serb kishte dalë prej Kosove), nuk ka pasur asnjë veprimtarë qoftë edhe individuale të luftëtarëve të UÇK-së dhe nuk ka pasur asnjë objekt të mbajtur nën kontroll nga këta luftëtarë. Kështu, që ju për adresime të pas kësaj date mund dhe duhet të gesh adresat të reja zotëri Marty, se në zonën time të përgjegjësisë nuk mund të etiketosh.

Por ju nuk vazhdoni kronologjinë në kohë. I përzieni kohët me qëllim. Në pikën 132 ju ndër të tjera shpreheni: “... kryenin shpesh kalimet nga njëri vend në tjetrin përmes rrugëve shqiptare dhe përmes kufirit të depërtueshëm e kaotik (sidomos në çastin e zhvendosjeve masive të refugjatëve në mesin e viti 1999) midis Kosovës e Shqipërisë”. Është e vërtetë zotëri Marty që kufiri nga marsi deri në qershor 1999 ka qenë i lirë nga ana e Shqipërisë, për të hyrë të shpërngulurit. Me gjithë dëshirën tuaj dhe të Serbisë që ne t’i linim këta qytetarë të shpërngulur nën armët e serbëve që t’i vrisnin pa dhembje, siç edhe kanë vrarë jo pak por mbi 14 mijë, ne ishim të detyruar ta lironim kufirin, pasi ata jo vetëm ishin vëllezërit tanë, por në radhë të parë ishin njerëz që kishin nevojë për ndihmë. Por që kufiri ka qenë kaotik, kjo nuk është e vërtetë. Këtë e dinë shumë mirë serbët, por nuk ua kanë thënë.

Ndërsa kur thoni se: “... luftëtarë e simpatizantë të UÇK-së kanë kryer transportime të shumta drejt e ndërmjet qendrave të përmendura në këtë raport dhe kanë transportuar po ashtu robër nga shumica e këtyre vendndodhjeve”. (në pikën 133). Mua më habit, sepse luftëtarët nuk kishin automjete për të transportuar edhe fëmijë në nevojë, ku i paskan gjetur mjetet për robërit dhe nga çfarë rrugësh paskan kaluar? Zotëri ju nuk mund ta merrni me mend se si zhvilloheshin ngjarjet në atë kohë. Ju as nuk keni interes ta njihni të vërtetën e asaj periudhe. Por duhet të dini se objekti i punës së çdo luftëtarë në atë kohë ishte si të ishte sa më parë në frontin e luftës dhe si ta furnizonte sa më mirë atë front me mjetet, armët dhe municionet e nevojshme. Për të tjerat mund të kujtoheshin vetëm ata që mendonin si ju, që të gjithë shqiptarët janë kriminelë, se ashtu iu interesonte të propagandonin, siç edhe propagandonin, serbët dhe bashkëpunëtorët e tyre, që janë njëkohësisht edhe bashkëpunëtorët tuaj në këtë ndërmarrje të pistë. (Vijon)

Si u shkatërrua kultura angleze në Shqipëri?



Familja Carnarvon ka qenë ndër familjet më të njohura dhe më me influencë në Britani të Madhe. Pallati i tyre Highclere, edhe sot është ndër më të bukurit në botë dhe aty është xhiruar seriali 'Downton Abbey'.

Fama e kësaj familje u rrit dhe mori përmasa botërore kur në vitin 1922, Lord Carnarvon, vëllai i Aubrey Herbert-it, zbuloi varrin e Tutankamonit, faraonit më të famshëm egjiptas. Me këtë pasuan

vdekjet në familjen Carnarvon, përfshirë atë të Aubrey Herbert-it, kampionit të pavarësisë së Shqipërisë. Për këtë arsye, kjo u bë temë e 'Mallkimit të faraonëve' që vazhdon edhe sot.

Në vitin 1928, kontesha Carnarvon bëri një hap tejet fisnik. Në shenjë të nderimit të birit të saj, Aubrey Herbert, mikut më të mirë që patën shqiptarët, e themeloi programin të cilin e quajti 'Për Djelmërinë'. Programi

parashihte ngritje kulturore të Shqipërisë e cila do të ndikonte edhe në forcimin e pavarësisë së këtij shteti për të cilin familja Carnarvon nuk kursyen asgjë. Dhe, kështu, kontesha Carnarvon në Tiranë e bleu tokën dhe e ndërtoi bibliotekën që ishte në kuadër të Institutit "Herbert". Në bibliotekë, kontesha solli 3000 kopete me tituj të ndryshëm në anglisht, por edhe në gjuhë tjera, përfshirë shqipen. Aty ndërtoi edhe fushën e tenisit.

Vendi u bë qendër ku rinia shqiptare e frekuentoi me të madhe dhe filloi të evropianizohej shpejt.

Pastaj, kontesha solli mjekë dhe pajisje nga Anglia për spitale të ndryshme, duke e dalluar atë të çmendisë në Vlorë. E thau një pjesë të kënetës dhe e ndërtoi fshatin Herbert për refugjatët e Kosovës, të cilët e themeluan mirë dhe zhvilluan një ekonomi artizanale, të cilat prodhime kontesha i plasonte në tregun britanik. Kontesha ndërtoi edhe

një spital për trajtimin e kafshëve. Ka shumë mundësi që ky spital të jetë i pari i këtij lloji në Ballkan.

Kontesha bëri edhe shumë gjëra tjera, përfshirë prurjen e kulturës së pirjes së çajit të pasdites ku mblidheshin gratë për biseda.

Për fat të keq, ky depërtim i kulturës angleze në Shqipëri, nuk zgjati shumë, pasi që u ndërpre në vitin 1939 me pushtimin italian. Biblioteka u shndërrua në kazermë ushtarake italiane, kurse librat u zhdukën. Kjo ka ndodhur me iniciativën e Qeverisë shqiptare nën tutelën e fashizmit italian, kur ministër i Arsimit/Kulturës ka qenë Ernest Koliqi. Britania e Madhe dhe kultura anglo-saksone atëherë ishte armike e fashizmit italian dhe, si rrjedhojë, edhe e Shqipërisë.

Shkatërrimi i kësaj kulture vazhdoi edhe me komunizmin. Madje, edhe më shumë. Biblioteka u bë kinema ("Ali Demi") dhe të gjitha veprimet tjera u ndaluan, kurse fshatit Herbert iu ndërrua emri në Qerret. Përkundër tërë këtij kontributi, Aubrey Herbert, kontesha dhe familja Carnarvon nuk u përmendën kurrë deri me rënien e komunizmit. //Telegrafi/

Festivali i filmit në Venecie do të mbahet në formë fizike por me shumë ndryshime

Në vitin 2019 festivali i filmit në Venecie karakterizohej nga gjallëria, paparazit, zhurmat dhe turmat e mëdha të njerëzve.

Por, pandemia e koronavirusit ka bërë që sivjet kjo ngjarje e rëndësishme kinematografike, që njëherësh do të jetë festivali i parë që do të mbahet në formë fizike prej se ka filluar kriza shëndetësore, megjithatë të duket shumë më ndryshe nga festa e zakonshme në qytetin romantik italian.

Tradicionalisht, në festivalin e Venecias yjet e filmit vinin në qytet me barka, ku pastaj priteshin nga adhuruesit e entuziazmuar me të cilët pozonin për fotografi dhe u nënshkruanin autografe. Një tjetër karakteristike e festivalit ishte edhe atmosfera energjike mbi qilim të kuq.

Ndërsa këtë vit, publikut i është kërkuar të mos e rrezikojë shëndetin duke marrë pjesë në ngjarje të këtylla ku mblidhen shumë njerëz, dhe kështu t'i



rezistojnë dëshirës për t'i takuar idhujt e tyre të kinematografisë. Si pasojë, premierat me qilim të kuq për filmat pjesëmarrës të festivalit, do të zhvillohen pa prezencën e fansave.

Protokolli i mbrojtjes nga

COVID-19 do të thotë se, çdo personi që e ndjekë festivalin do t'i matet temperatura me të arritur në vendngjarje, dezinfektimi i duarve do të jetë i vazhdueshëm, mbajtja e distancës sociale do të praktikohet

në çdo ambient, maskat janë obliguese gjatë shikimit të filmave dhe konferencave për media dhe si pasojë, kinematë do të jetë gjysmë të mbushura me publik. Pandemia po ashtu ka bërë që numri i filmave konkurrent të jetë

më i vogël këtë vit, dhe prezenca e yjeve të listës A në Hollywood do të jetë shumë e vogël dhe e limituar.

Edicioni i 77-të i festivalit të filmit në Venecie, do të mbahet nga data 2 deri më 12 shtator.



SENATORI I AMERIKËS BOB DOLE KTHEHET NË PRISHTINË I DERDHUR NË BRONZ



Ismet SYLEJMANI

Pas ngujimit të minatorëve trima e heroik të Trepçës në zgafellat e nëntokës; pas grevës legjendare të tyre; pas organizimit nga LPRK të demonstratave masive të marsit të vitit 1989; pas organizimit para Grandit në Qendër të Prishtinës të demonstratës nga LPRK në maj të vitit 1989 me rastin e ardhjes së delegacionit të Parlamentit Europian; pas rrethimit,

dyluftimit epik dhe rënies heroike në Breg të Diellit në Prishtinë të Udhëheqësit të LPRK-së, Heroit të Kombit Afrim Zhitia dhe shokut e bashkëveprimtarit të tij, drejtuesit të lartë të LPRK-së në Kryeqytetin e Kosovës, Heroit të Kombit Fahri Fazliu; pas Deklaratës së 2 Korrikut 1990, erdhi radha e paralajmërimit historik të vizitës së delegacionit të lartë të Senatit të SHBA-ve në Prishtinë, në Krahinën autonome të Jugosllavisë në Kosovë! Amerikën në Kosovë, në vitin 1990, populli shqiptar e priti me madhështi! LPRK luajti rol të madh organizativ në organizimin e demonstratës me rastin e vizitës së delegacionit amerikan në

Kosovë!

E gjithë bota e pa nga afër se sa shumë dashuri, respekt e konsideratë ushqente për SHBA-në populli shqiptar i Kosovës! Më 29 Gusht të vitit 1990, ishte një ngjarje e madhe historike, sepse ardhja e delegacionit të lartë amerikan në Kosovë, u shëndërrua në paralajmërim konkret dhe historik për popullin shqiptar të Kosovës në përgjithësi dhe për radhët e organizuara ilegale politiko-patriotike dhe për LPRK në veçanti, se Kosova po fillonte një fazë të re, në të cilën organizimi politik dhe pergaditja e shtratit të luftës së armatosur kundër Serbisë pushtuese do të ishte shumë e ashpër dhe me shumë të

papritura, por e domosdoshme dhe e mundshme!

Lufta heroike dhe titanike e UÇK-së, gjaku i derdhur për liri i Heronjëve dhe Dëshmorëve, ndihma e madhe kolosale e SHBA-së dhe bombardimi i NATO-s mbi Serbinë dhe caqet e saja ushtarake në Kosovë, sollën çlirimin e Kosovës nga Serbia dhe largimin e sajë nga Kosova! Kthehet i derdhur në bronz Senatori i famshëm i SHBA-ve Bob Dole, në 30 vjetorin e vizitës së parë të madhe të delegacionit amerikan në Kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë! Populli shqiptar e ka dëshuar me vepra nëpër histori, se din dhe është mirënjohës për jetë të jetëve të miqëve të mëdhenj e aleatëve historik!

Të atyre që na e kanë zgjatur dorën e ndihmës njerëzore e ushtarake dhe na kanë ndihmuar të ecim dhe të rrojmë me dinjitet njerëzorë dhe kombëtar!

Pas Shqipërisë Nënë, Amerika është e para, që na ka dhënë dhe na ka ndihmuar më së shumti! Faleminderit Senatori i madh dhe historik i Amerikës për Kosovën, i nderuar Bob Dole! Mirësevjen i dashur dhe shumë i nderuar Bob Dole, në Kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë!

Faleminderit Amerikës dhe Ty! Mirënjohës përgjithmonë!

Ismet Sylejmani, ish veprimtarë dhe drejtues i lartë i LPRK-së! Prishtinë, 29 Gusht 2020!

E rrallë

Elon Musk prezanton derrin me mikroçip elektronik në tru

Elon Musk ka prezantuar derrin e quajtur Gertrude të cilit i është implantuar një mikroçip "regjistruar" në tru, me të cilin manjati i teknologjisë demonstroi planet ambicioze për ndërlidhjen e trurit të gjallë me makinerinë. "Është si një copë e vogël në tru me tela shumë të vogla", ka pohuar milioneri sipërmarrës në një koment, të cilin kompania e tij 'Neuralink' ka nisur ta testojë te njerëzit.



BARSOLETA E DITËS




Nëna e lëvdon vajzën para burrit potencial.
- Ajo përgatit ushqimin për mrekulli. Është magjike në kuzhinë. Zemër, a e pastrove sallatën?
- Jo, ende. Nuk kishte detergjent.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

FOTO E DITES



Pamje nga plazhi i Golemit në Shqipëri



E jashtëzakonshme

Theu karantinën për të parë të dashurën, australiani dënohet me burg

Një djalë në Australi ka thyer rregullat e karantinës vetëm për të parë të dashurën. Yusuf Karakaya përdorte shkallët e fshehta të hotelit ku ishte karantinuar për ta takuar të dashurën e tij. Këtë veprim ai e kishte bërë disa herë deri në momentin që u kuptua nga rojet e hotelit ku menjëherë ata e raportuan në organet përkatëse. Karakaya u dënua me gjashtë muaj burg, mirëpo më pas ky vendim u pezullua dhe ai tani do të bëjë vetëm një muaj burg.

 <p>DASHI Do të ndiheni konfuz, sidomos në dashuri. Do t'i nxirrni në pah defektet e njeriut tuaj të zemrës. Fokusoheni më shumë në jetën profesionale.</p>	 <p>DEMI Pritet që nesër të jetë një ditë pozitive, edhe pse Merkuri është në një orbitë që nuk ju mbështet aq sa duhet.</p>	 <p>BINJAKËT E vetmja gjë negative është se mund të zhgënjeheni nga një person. Në vendin e punës mund të keni probleme.</p>	 <p>GAFORRJA Shmangni polemikat dhe zënkat në dashuri dhe në familje apo në raport me të tjerët. Mund të përballeni me tensione të forta.</p>	 <p>LUANI Yjet janë në anën tuaj dhe rezultatet nuk do të vonojnë. Shumë shpejt do të merrni vlerësime edhe në sferën profesionale.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Lejoni veten që të udhëhiqeni nga instinkti dhe nuk do të gaboni. Sa i takon dashurisë, keni mbështetjen e yjeve dhe mund të hidhni hapin e madh.</p>
 <p>PESHORJA Dita e nesërme do të jetë e qetë për ju, por që gjithsesi do të jetë e përkohshme. Situata pritet të ndryshojë, kjo edhe në saje të ndikimit të Mërkurit.</p>	 <p>AKREPI Mos mendoni për të kaluarën, por shikoni përpara. Mos rri peng në një histori që e keni lënë pas duke menduar për hakmarrje.</p>	 <p>SHIGJETARI Dita do të jetë e qetë, pas disa vështirësive që keni kaluar në jetën sentimentale. Këshillohet që të tregoheni i kujdesshëm.</p>	 <p>BRICJAPI Nën ndikimin e planetëve të shumtë do të arrini të vini në vijë një ide apo projekt, por nuk duhet që ta lini përgjysmë.</p>	 <p>UJORI Do të keni mundësi që të bëni gjëra të rëndësishme. I vetmi aspekt ku duhet të tregoni kujdes, janë financat.</p>	 <p>PESHQIT Dita e parë e muajit do të jetë mjaft e ngarkuar për shkak të disa problemeve ekonomike dhe burokratike.</p>

Adele shfaqet me 44 kilogramë më pak, habit të gjithë me daljen e fundit në bikini



Daljet e saj të fundit kanë qenë më të komentuar ndoshta se të gjitha vitet e saj të karrierës, kjo për shkak të ndryshimit drastik në pamjen e saj. Adele më në fund na ka dhënë një pamje

nga koka te këmbët pasi ka rrrëzuar plot 44 kilogramë që nga nisja e dietës së rreptë. Në një fotografi të ndarë në "Instagramin" e saj, këngëtarja shfaqet me një pamje të veçantë.

Ledri, pushime me shokët, Sara pozon shtatzënë



Ledri Vula dhe Sara Hoxha e kanë shijuar në maksimum verën e këtij viti si prindër në pritje në jug të Shqipërisë. Megjithatë, duket se çifti i famshëm ka gjetur kohë edhe për angazhime të tjera larg njëri-tjetrit. Reperi 34-vjeçar është ribashkuar me dy miqtë, gjithashtu bashkëpunëtorë besnikë në

muzikë, Lumi B dhe Ermal Fejzullahu, për të pushuar së bashku. Ledri ka publikuar në llogarinë e vet në "Instagram" disa video në story, ku shihet në një resort në plazh duke ia kaluar më së miri me shokët. Ndërkohë Sara e ka shfrytëzuar këtë kohë për ta realizuar setin e parë fotografik shtatzënë.



Melinda, lëvizje provokuese me këngën e re me Gjikon

Melinda dhe Gjiko kanë publikuar dhe bashkëpunimin, këngën me titull 'X5' të cilën e kanë sjellë me videoklip. Melinda po e shijon suksesin e bashkëpunimit me Gjikon. Kënga "X5" u pëlqye shumë nga publiku dhe në të

Melinda u shfaq mjaft atraktive, detaj ky i cili nuk kishte se si të mos binte në sy. Po aq atraktive ajo u shfaq edhe në videot e publikuara në rrjete sociale, ku shihet duke kërcyer me këngën e saj të re. Reperja bënte ndërkohë lëvizje provokuese.

Johnny Depp hedh miliona dollarë për tjetër gjyq me ish-gruan



Aktorja Amber Heard do ta shohë veten sërish në gjyq me ish-bashkëshortin e saj Johnny Depp, edhe pse ylli i "Piratëve të Karaibeve" humbi gjyqin kundër gazetës "The Sun". Teksa aktorja e Hollywoodit fluturoi të dielën për pushime në Turqi përpara verdiktit që pritet të dalë këtë javë, në një përballje dra-

matike në gjyq me Johnny Depp, skuadra e saj ligjore po përgatitet për një tjetër "luftë" në gjykatë. 57-vjeçari Depp po përgatit paratë për të hedhur sërish në gjyq ish-gruan për prova të reja për dhunën familjare brenda shtëpisë së tyre. Ai është gati të shpenzojë miliona dollarë të tjerë për përballjen e radhës.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Challandes: Ndeshjet ndaj Moldavisë dhe Greqisë t'i shfrytëzojmë për barazhin me Maqedoninë

Trajneri Bernard Challandes të hënën në konferencë për media e vazhdoi edhe për dy vjet të tjera kontratën me Federatën e Futbollit të Kosovës. Më pas strategu zviceran ka folur për dy ndeshjet e muajit shtator ndaj Moldavisë dhe Greqisë në Ligën e Kombeve. "Liga e Kombeve nuk është e njëjtë si ajo para Evropianit. Qëllimi ynë është që të rritemi përmes Ligës së Kombeve dhe këto ndeshje do të jenë përgatitje për barazhin me Maqedoninë e Veriut", ka thënë Challandes



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 GUSHT - Trajneri Bernard Challandes edhe zyrtarisht e ka vazhduar kontratën me Federatën e Futbollit të Kosovës, për t'u prirë "dardanëve" deri në vitin 2022. Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, është shprehur se të gjithë janë të kënaqur me punën dhe rezultatet e trajnerit zviceran. "Jemi të kënaqur me punën dhe rezultatet e Challandesit, i cili me ekipin e vet ka krijuar një filozofi të re në ekipin tonë nacional dhe normalisht, përveç punës së tij, sigurisht ka bërë edhe planet edhe për ekipin zinxhir që bashkërisht në të ardhmen do të jetë një linjë ose një format i njëjtë i të gjitha kombëtareve tona me një filozofi të punës e cila na përshtatet", ka deklaruar Ademi në konferencën për media, ku edhe u nënshkrua vazhdimi i kontratës në mes të FFK-së dhe trajnerit Challandes.

Strategu zviceran është shprehur i lumtur se do të vazhdojë të jetë trajner i Kosovës edhe në dy vjetët e ardhshëm. "Shpresoj të jem trajner më i mirë se sa biznesmen (qesh). Jam shumë i lumtur për vazhdimin e bashkëpunimit me FFK-në. Gjëja më e

rëndësishme për mua është futbollit dhe vazhdimi i bashkëpunimit me këta lojtarë. Ne duhet të kemi durim, jemi ekip i ri dhe duhet të ngrehemi ngadalë", ka thënë Challandes.

Kosova do t'i zhvillojë dy ndeshjet e para në Ligën e Kombeve në muajin shtator ndaj Moldavisë dhe Greqisë. Strategu zviceran e ka pranuar se nuk është aspak e lehtë që të krijohet një ekip ideal për këto ndeshje. "Kemi dy ndeshje, ku duhet të ndërtojmë ekipin së pari për takimin me Moldavinë e pastaj me Greqinë. Nuk është e lehtë ta kombinosh ekipin për këto ndeshje. Kemi lojtarë që nuk kanë luajtur shumë, lojtarë që kanë luajtur dhe disa që po transferohen në klube. Nuk mund t'i përdorim lojtarët që sapo kanë filluar përgatitjet në të dy ndeshjet, pra është e vështirë për të gjetur ekip ideal për ndeshjet e shtatorit", ka shtuar Challandes, i cili i sheh dy ndeshjet e shtatorit si përgatitje për ndeshjen gjysmëfinale ndaj Maqedonisë së Veriut. Ai ka thënë se Kosova ka bërë përparim në Ligën e Kombeve dhe se lojtarët duhet ta rinisin përparimin e tyre për ekipin përfaqësues. "Situata nuk është e lehtë dhe nuk është e tillë vetëm për ne. Kemi lojtarë të kampionateve të ndryshme për të cilët nuk do të jetë e lehtë. Duhet

të adaptohen. Sa i përket Ligës së Kombeve nuk është e njëjtë si ajo para Evropianit. Qëllimi ynë është që të rritemi përmes Ligës së Kombeve dhe këto ndeshje do të jenë përgatitje për barazhin me Maqedoninë e Veriut. Ne kemi bërë progres në këtë ligë dhe unë do të kërkoj nga lojtarët që ta rrisim progresin edhe ndaj këtyre kombëtareve. Lojtarët duhet të japin më të mirën për kombëtaren", ka deklaruar Challandes.

Rashkaj grumbullohet me 'dardanët', Rashica luan ndaj Moldavisë

Ylli i futbollit i Kosovës, Milot Rashica, është lejuar nga skuadra e Werder Bremenit që t'u ndihmojë "dardanëve" në ndeshjen hapëse në edicionin e ri të Ligës së Kombeve kundër Moldavisë, por jo edhe kundër Greqisë këtë muaj. "Milot Rashica do të udhëtojë drejt Italisë këtë javë për t'u përballur me Moldavinë me ekipin e Kosovës. Ai nuk do të lejohet të luajë në ndeshjen e dytë në Prishtinë", thuhet në njoftimin e Werderit. "Dardanëve" të hënën u është bashkuar mesfushori Anel Rashkaj, i cili paraprakisht ishte në listën rezervë të përzgjedhësit Bernard Challandes.

SHKURT

Berisha konfirmon largimin nga Feronikeli

Mbrojtësi i njohur Ilir Berisha e ka zyrtarizuar largimin nga skuadra e Feronikelit. Berisha ka bërë me dije se me marrëveshje të dyanshme e kanë ndërprerë kontratën, por nuk ka dhënë detaje të tjera lidhur me ndërprerjen e saj dhe të ardhmen e vet. "Nuk do të jem pjesë e KF Feronikelit në sezonin e ardhshëm pasi kemi arritur marrëveshje të dyanshme me drejtuesit e klubit për ndërprerjen e kontratës. Falënderoj KF Feronikeli, shtabin teknik, bashkëlojtarët dhe 'Tigrat e Zi' për këtë kohë dhe u dëshiroj suksese në vazhdimësi", ka shkruar Berisha në profilin e vet në "Facebook".

Trepça '89 vazhdon me Idrizin

Shpëtim Idrizi do të jetë trajner i Trepçës '89 edhe në edicionin e ri të garave. Trajneri që riktheu lojën e bukur me skuadër të re në "Riza Lushta", ka konfirmuar marrëveshjen me klubin. "Po, jemi marrëveshje që unë të jem trajner i Trepçës '89 edhe në kampionatin e ri në Superligë", ka thënë Idrizi për "Olle". '89-shi shpëtoi vetëm në xhiron e fundit, duke mundur Prishtinën 2:1 dhe duke rrëzuar Flamurtarin në Ligën e Parë.

Marrëveshja për transferimin e Muriqit në Lazio, shumë afër

Vedat Muriqi duket se do të jetë lojtar i ri i skuadrës së Lazios. Futbollisti nga Kosova është pajtuar t'i bashkohet klubit italian, por Fenerbahçe dhe Lazio ende nuk kanë arritur marrëveshje për këtë transferim. Lazio ka ofruar 16 milionë euro plus dy të tjera bonuse, ndërsa klubi turk kërkon 20 milionë për ta lënë të lirë shtatartarin. "Sky Sports" ka raportuar se ka përparime në negociatën mes dy klubeve, kurse marrëveshja për transferimin e Muriqit në Serinë A mes dy klubeve raportohet se do të arrihet gjatë kësaj jave.

Bunjaku vazhdon me KB Ylli

KB Golden Eagle Ylli ka njoftuar se e ka vazhduar kontratën me basketbollistin Valon Bunjaku. "Ju njoftojmë se kemi arritur marrëveshje me për vazhdimin e kontratës edhe për sezonin 2020/2021 me njërin nga akteret kryesor të sezonit të kaluar plejmikerin me të mirë vendor Valon Bunjaku. Në ndërkohe jemi ende në pritje të informatave nga FBK-ja për fillimin e stërvitjeve për një vit të zjarrtë që na pret", thuhet në njoftimin e KB Yllit.

FC Prishtina: Lilaj, futbollisti më i shtrenjtë në tridhjetë vjetët e fundit në Kosovë

PRISHTINË, 31 GUSHT - FC Prishtina e ka prezantuar transferimin e mesfushorit Sabien Lilaj. Klubi kryeqytetas e ka vlerësuar Lilajn si mesfushorin më të talentuar në Kategorinë Superiore të Shqipërisë, derisa bëri me dije se ai është transferi-

mi më i shtrenjtë i transferuar në tridhjetë vjetët e fundit në Kosovë. "Sabien Lilaj, ikona e Skënderbeut të artë. Mesfushori më i talentuar i Kategorisë Superiore. Futbollist me pak klube. Prishtina vetëm skuadra e gjashtë në karrierë. KF

Tirana nga moshat e reja (1999-2011), Lokomotiva Zagreb (2011-2012), Skënderbeu (2012-2018), Gabala, Azerbajxhan (2018-2019) dhe Sektizia Nes Tziona, Izrael (2019-2020). Ka dëshirë: Prishtina ta arrijë titullin dhe të mbetet

klubi i fundit në karrierë! Pa dyshim, Sabieni është futbollisti më i shtrenjtë i transferuar në tridhjetë vjetët e fundit si i Prishtinës, po ashtu edhe i kampionatit në Kosovë", thuhet në njoftimin e Prishtinës.



Short i vështirë për skuadrat shqiptare në Ligën e Evropës, Drita përballet me Sileksin



PRISHTINË, 31 GUSHT - Është hedhur të hënën në Nyon të Zvicrës shorti për turin e dytë eliminator të Ligës së Evropës, fazë në të cilën marrin pjesë plot 6 klube shqiptare, Drita nga Kosova, Kukësi, Laçi e Teuta nga Shqipëria dhe Shkëndija e Renova nga Maqedonia e Veriut.

Kampionia e Kosovës, Drita nga Gjilani, do të përballet me ekipin e Maqedonisë së Veriut, Sileksin, në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Evropës. Sileksi do të jetë vendas në këtë ndeshje që do të zhvillohet më 17 shtator.

Drita më herët ka marrë pjesë në turneun preliminar të Ligës së

Kampionëve, por është eliminuar para ndeshjes finale për shkak të rasteve të futbollistëve me Covid-19. Pas eliminimit nga Liga e Kampionëve, Drita garat i ka vazhduar në Ligën e Evropës. Ndërsa skuadra e Teutës, pasi kaloi me sukses izraelitët e Beitar Jerusalem, do të përballet në turin e dytë me spanjollët e Granadës, ndërsa goglat përcaktuan pikërisht skuadrën durrsake si pritëse, me ndeshjen që do të zhvillohet në "Niko Dovana" më 17 shtator. Një tjetër përballje shqiptar-izraelite do të ketë edhe në turin e dytë eliminator të Ligës së Evropës, pasi Laçi shmangu anglezët e Tottenhamit dhe

do ta diskutojë kualifikimin përballë Hapoel Ber Sheva, me sfidën që do të luhet në Shqipëri më 17 shtator. Short mjaft i vështirë për Kukësin e Skënder Gegës, që do të luajë sërish si pritës, por do t'i gjejë përballë gjigantët gjermanë të Wolfsburgut, që ishin edhe kundërshtarët më të fortë të mundshëm. Ndërkohë, Shkëndija e Tetovës do të luajë sërish në transfertë, këtë herë përballë rumunëve të Botoshanit, ku do të ketë një tjetër shans të mirë për ta vijuar aventurën evropiane. E pafat skuadra e Renovës, pranë Tetovës, do t'i presë kroatët e Hajdukut të Splitit, në sfidën që do të zhvillohet më 17 shtator në kryeqytetin e Maqedonisë Veriore, Shkup.

Tirana kualifikohet pa luajtur, një hap larg grupeve në Ligën e Evropës

Tirana ka pasur shumë fat në shortin e hedhur në Nyon sa i përket Ligës së Evropës, pasi skuadra bardheblu që u eliminua në turin e dytë të Ligës së Kampionëve ndaj Crvena Zvezda, do të luajë direkt në "play-off" të Ligës së Evropës dhe ka kaluar automatikisht pa luajtur turin e tretë. Nga 10 skuadra që kishin kaluar më tej, dy prej tyre përfitonin kalimin e turit dhe bardheblutë ishin me fat. Kështu, goglat kapën Tiranën dhe Ludogorets që tani kanë shansin të shkojnë në grupet e Ligës së Evropës me një finale të fundit.

Clippersat kualifikohen në çerekfinalet e 'play-off'-it

ORLANDO, 31 GUSHT - Los Angeles Clippers është skuadra e radhës që siguron kualifikimin në çerekfinalet e "play-off"-it në NBA, pasi mposhti Dallas Mavericksin me shifrat 111-97, në sfidën e zhvilluar në "AdventHealth Arena" të Orlandos. Luka Donçiq bëri sërish një paraqitje mjaft të mirë për Mavericksin, që gjithsesi mori humbjen e katërt përballë skuadrës kaliforniane dhe u eliminua me rezultatin e përgjithshëm 4-2. Nga ana tjetër, për Clippersat shkëlqeu Kawhi Leonard me 33 pikë, 14 rikuperime dhe 7 asistime. Denver Nuggetsit rihapi shpresat për kualifikim, pasi ia doli të

triumfojë ndaj Utah Jazzit me shifrat 119-107 dhe të barazojë në 3-3 rezultatin e përgjithshëm, ndërsa çerekfinalistja do të përcaktohet vetëm në takimin e shtatë, që do të jetë një finale e vërtetë. Kanadezi Jamal Murray ishte fantastik për Denverin, pasi arriti të shënojë 50 pikë, t'i rikuperojë 5 topa dhe të japë 6 asistime, ndërsa edhe Donovan Mitchell i Utahit bëri një ndeshje mjaft të mirë, por që nuk i mjaftoi Jazzit për ta siguruar kualifikimin. Po ashtu, u zhvillua edhe përballja e parë çerekfinale mes Toronto Raptorsit dhe Boston Celticsit, 112-94. Tatum, Smart



dhe Brown ishin në një formë mjaft të mirë për Celticsin, që dominuan në 3 nga 4 fraksionet e lojës së zhvilluar në "HP Field House" të Orlandos.

SHKURT

Seria A fillon më 19 dhe 20 shtator

Seria A ka konfirmuar se sezoni 2020-2021 do të fillojë më 19 dhe 20 shtator. Kalendarin do të bëhet publik më 2 shtator. Federata ka vendosur për datat e sezonit të ri pas një takimi të mbajtur në Romë sot. Java e parë e kampionatit do të luhet më 19 dhe 20 shtator, ndërsa kalendarin do të zyrtarizohet më 2 shtator. Sezonin e kaluar Serinë A e fitoi Juventus, ndërsa këtë vit gara do të jetë më e fortë pasi ekipet janë përforcuar.

S'ka dilemë, Neymari qëndron në PSG


"Dua të pushoj dhe të rikthehem në finale", ky është titulli i "PSG le Mag" dhe fjalët janë të brazilianit Neymar, i cili ka dhënë një intervistë ekskluzive në revistën e mësipërme. Sulmuesi lëshon kështu një mesazh të qartë në lidhje me të ardhmen e tij. Ai nuk do të largohet nga PSG-ja, ku sezonin e fundit fitoi titullin kampion dhe Kupën e Francës. Gjithsesi peng i ka mbetur humbja e finales së Ligës së Kampionëve dhe Neymari dëshiron të rikthehet në finale dhe ta fitojë trofeun prestigjioz.

City hap 'thesin' për transferimin e Messit

Manchester City po punon fort që ta bindë Lionel Messin që të transferohet në Angli. Argentinasi dëshiron të largohet dhe ta pranojë ofertën e "Qytetarëve" dhe diçka e tillë nuk ndodh vetëm nëse Barça pengon totalisht lëvizjen. Messi është i bindur nga oferta e lartë e anglezëve. Ai pritet të përtojë 450 milionë paundë në 5 vjet. City do t'i ofrojë 2 vjet kontratë në Premierë Ligë, deri në moshën 35-vjeçare më pas 3 vjet të tjera te New York City. Një ofertë e tillë që i jep mundësinë Messit të luajë deri në moshën 38-vjeçare me kushte shumë të mira është shumë joshëse për gjashtë herë fituesin e "Topit të Artë".

Lazio 'blindon' Immobilen

Sulmuesi Ciro Immobile ka nënshkruar kontratë të re me Lazion, e cila do ta mbajë atë në kryeqytetin italian deri në verën e vitit 2025. "Lajmi i sotëm është se Ciro Immobile është përkushtuar Lazios për edhe pesë vjet, deri më 2025", thuhet në një njoftim të Lazios. Immobile e fitoi "Këpucën e Artë" në Evropë sezonin e kaluar, duke i mposhtur në garë Robert Lewandowski dhe Bayern Munich dhe Cristiano Ronaldo dhe Juventusit. Ai i shënoi 36 gola në 37 ndeshje në Serinë A sezonin e fundit. Në total, Immobile i ka shënuar 125 gola në 178 ndeshje për Lazion, së cilës iu bashkua më 2016. Ai do t'i fitojë 4 milionë euro në vit në Lazio.



DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.1340 datë 31.08.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), UA nr.05/2015 (Normativit për mesimdhënësit e arsimit profesional), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2020/2021

1. SHFMU "Naum Veqilharxhi" në Mohlan

- Një mesimdhënësi/e për lëndën fizik-kimi për 10 orë mesimi në javë (deri në perfundim të mandatit të drejtorit të shkollës).
- Një mesimdhënësi/e për lëndë gjuhë gjermane, për 18 orë mesimi në javë me plotësim orësh në shkolla tjera.

2. SHFMU Dëshmorët e Tivarit" në Peqan

- Një mesimdhënësi/e për lëndën e edukatës qytetare me plotësim orësh në shkolla tjera.

3. SHFMU "V.P. Shkodrani" në Leshan

- Një mesimdhënësi/e për lëndë gjuhë gjermane, për 19 orë mesimi në javë me plotësim orësh në shkolla tjera (zëvendësim i pushimit të lehonisë).

4. SHFMU "Migjeni" në Gjinoc

- Vendi i punës :Një punëtor-e teknik/ndihmës
- Kualifikimi: Shkolla mesme
- Paga mujore: Koeficienti 4

5. SHFMU "Iliria" në Savrovë

- Vendi i punës :Dy (2) punëtor-e teknik/ndihmës
- Kualifikimi : Shkolla mesme
- Paga mujore: Koeficienti 4

6. SHFMU "Dituria" në Samadrexhë

- Vendi i punës :Një punëtor-e teknik/ndihmës
- Kualifikimi : Shkolla mesme
- Paga mujore: Koeficienti 4

Kushtet: Për të gjitha vendet e lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.10/2018.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diploma e shkollës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje) e vertetuar tek noteri.
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

7.Dy (2) Asistent/e për fëmijët me nevoja të veçanta në nivelin e DKA-së

Përgatitja shkollore: Shkolla e mesme dhe niveli i 5-të (post sekondar) i kualifikimit, asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Kohëzgjatja e kontratës : deri më 31.08.2021.

Punët dhe detyrat për asistent/e për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore:

- ✓ Ndihmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- ✓ Punon me mesimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndët individualizuara ose mesim në fushatë aktivitetëve;
- ✓ Përgatit material mësimorë si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme Brenda dhe jashtë klasës.
- ✓ Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatitin formata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve;
- ✓ Promovon arsimin gjithë përfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, për pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës perms bisedës dhe lojës;


- ✓ Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- ✓ Planifikon me mesuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mesim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mesim;
- ✓ Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- ✓ Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- ✓ Prezenton punën dhe arritjet e nxënësve. Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale;

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diplomën ose Certifikatën e diplomës së kualifikimit të nivelit të pestë (5-të) PEARSON kopje e vërtetuar,
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati i konkurimit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE

05 br.1340 od 31.08.2020 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03 / L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosova br. 04 / L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosova br. 03 / L-068, AI br.10 / 2018 (Normativa o stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), AU br.05 / 2015 (Normativa za nastavnike stručnog obrazovanja), Administrativnog uputstva br.07 / 2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Opštinska direkcija za obrazovanje objavljuje sledeće:

KONKURS

Za popunu slobodnih radnih mesta za školsku godinu 2020/2021

1. ONSŠ "Naum Veqilharxhi" u Movljane

- Jedan nastavnik/ca za predmet fizika - hemija za 10 časova nedeljno (do kraja mandata direktora škole).
- Jedan nastavnik za predmet nemačkog jezika, za 18 časova nedeljno sa dodatnom nastavom u drugim školama.

2. ONSŠ "Dëshmorët e Tivarit" u Peçane

- Jedan nastavnik/ca za predmet građanskog vaspitanja sa dodatnim časovima u drugim školama.

3. ONSŠ "V.P. Shkodrani" u Leşanu

- Jedan nastavnik za predmet nemačkog jezika, za 19 časova nedeljno sa dodatnom nastavom u drugim školama (zamena porodiljskog odsustva).

4. ONSŠ „Migjeni“ u Đinovce

Radno mesto: jedan tehnički / pomoćni radnik

Kvalifikacija: Srednja škola

Mesečna plata: Koeficijent 4

5. ONSŠ „Iliria“ u Savrovu

Radno mesto: Dva (2) tehnička / pomoćna radnika

Kvalifikacija: Srednja škola

Mesečna plata: Koeficijenti 4

6. ONSŠ "Dituria" u Samadređu

Radno mesto: Jedan tehnički / pomoćni radnik

Kvalifikacija: Srednja škola

Mesečna plata: Koeficijenti 4

Uslovi: -Za ova slobodna radna mesta objavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU MONT br.10/2018.

Dokumentacija potrebna za konkurs:

- Obrazac (prijava) koji kandidat popunjava
- Diploma ili potvrda stepena stručne spreme umesto diplome, koja ne sme biti starija od šest meseci (fotokopija).
- Izvod rođenja
- Lična karta (fotokopija)
- Dokaz o radnom iskustvu u obrazovanju (ako ga ima)
- Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)

7. Dva (2) Asisenata/kinja za decu sa posebnim potrebama na nivou ODO

Školska sprema: Srednja škola i V nivo (sekondarni položaj) kvalifikacije, asistent za decu / učenike sa posebnim obrazovnim potrebama.

Trajanje ugovora: do 31.08.2021.

Poslovi i obaveze za pomoćnike za decu sa posebnim obrazovnim potrebama:

Pomaže deci / učenicima u razvoju i promociji nezavisnosti, orijentacije i mobilnosti, prevoza, položaja i sedenje učenika u učionici; u

Sarađuje sa nastavnicima i drugim osobljem na implementaciji PIA-a, individualizovanih predmeta ili učenja u kampanjskim aktivnostima;

Priprema nastavne materijale i upravlja potrebnom opremom unutar i izvan učionice.

Prati i dokumentuje utvrđene poteškoće i potrebe dece, priprema povratne formate za poteškoće i postignuća dece;

Promoviše inkluzivno obrazovanje i prijem sve dece u učionicu, podstiče decu u komunikaciji, da učestvuju u igri i podstiče govor i jezik kroz razgovor i igru;

Nadgleda i pomaže deci / učenicima tokom obroka hrane, brine o fizičkim i medicinskim potrebama učenika i pomaže u njihovom odevanju i opštoj čistoći;

Planira sa nastavnikom dnevni i nedeljni program za učenje, aktivnosti i događaje kako bi podržao decu u učenju;

Promoviše saradnju između kuće i škole, podržava i razgovara o osetljivim pitanjima sa roditeljem / starateljem;

Postuje pravila i etiku škole, dobro ponašanje prema učenicima;

Predstavlja rad i dostignuća učenika. Tretira školske podatke kao potpuno poverljive;

Neophodna dokumentacija za konkurs:

- Obrazac prijave (zahtev) koji popunjava kandidat
- Diplome ili Uverenje o diplomu o kvalifikaciji pete (5.) PEARSON overene kopije,
- Izvod rođenja
- Lična karta (fotokopija)
- Dokaz o radnom iskustvu (ako postoji)
- Sertifikati o završenim obukama akreditovani od MONT-a (ako ih ima)

Kompletna dokumenta se dostavljaju fotokopirana, dok se originalna dokumenta predstavljaju na intervjuu.

Nepotpune dokumente i one koji stignu posle roka, komisija ne razmatra. Prijave se primaju i predaju u prijemnoj kancelariji u opštini Suva Reka.

Rok za konkurs 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja konkursa u novinama.

O rasporedu intervjuova bićete obavesteni na zvaničnoj veb stranici opštine Suva Reka i na oglasnoj tabli ODO.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

- ▶ Autoshkolla "Agimi" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik 810903296, nr bis. 70699303 dhe nr. fis. 600627428.

Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehe qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.

Avni Isuf Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "28 Nëntori" Prishtinë.

Bali Salih nga fshati Ticë shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore SHFMU "Ismet Uka" Ticë Skenderaj.

Zyrafete Imer Dani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ismet Uka" Ticë, Skenderaj klasa I-VIII.

- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:003049
 Datë: 23.07.2020
 Numri i dokumentit: 01036118

C.nr.43/20

GJKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Malsor Kryeziu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Arsim (Daut) Gjeka, nga fshati Cërmjan, Komuna e Gjakovës, me banim në SHBA, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Luan Gjeka, nga fshati Cërmjan, Komuna e Gjakovës, kundër të paditurës Valbone Gjeka, e vajzërisë Miranaj, nga fshati Cërmjan, Komuna e Gjakovës, tani me adresë të pa njohur, për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, me date.23.07.2020, mori këtë:

AKTVENDIM

I. Të paditurës Valbona Gjeka, e vajzërisë Miranaj, nga fshati Cërmjan, Komuna e Gjakovës, të cilit tani nuk i dihet adresa e saktë, **I CAKTOHET** përfaqësuesja e përkohshme Fehmije Zhubi, avokat nga Gjakova.

II. Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht deri sa Organi Kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim do të shpallet në gazetën zyrtare, në një nga gazetat e përditshme ditore si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Arsyetim

Paditësi Arsim Gjeka, nga fshati Cërmjan, Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari Luan Gjeka nga fshati Cërmjan, Komuna e Gjakovës, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi për zgjidhjen e martesës, kundër të paditurës Valbone Gjeka, e vajzërisë Miranaj, nga fshati Cërmjan, Komuna e Gjakovës, tani me adresë të panjohur në Amerikë.

Gjyqtari gjykues pas vlerësimit të shkresave të lëndës ka gjetur nga fletë kthesat për dorëzim personal se e paditura ka udhëtuar jashtë vendit respektivisht gjindet në SHBA, mirëpo pa e specifikuar adresën se ku jeton.

Gjyqtari gjykues pas marrjes së rekomandimit respektivisht emrit të avokatit nga ana e OAK-së, duke pasur parasysh se procedura për caktimin e përfaqësuesit ligjor do të zgjatë

Numri i lëndës: 2020:003049
 Datë: 23.07.2020
 Numri i dokumentit: 01036118

shumë, e në anën tjetër do të shkaktohet dëme të pa nevojshme paditësit e me qëllim të evitimit të pasojave të dëmshme gjykata caktoj avokaten Fehmije Zhubi, nga Gjakova – përfaqësuese e përkohshme për të paditurën, gjersa ata apo e autorizuar e saj të paraqitet në këtë gjykatë apo gjersa Organi i Kujdestarisë të njoftojë se ka caktuar kujdestarin.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimin konfrom dispozitive të nenit 79.3 pika a të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

GJKATA THEMELORE NË GJAKOVË
 C.nr.43/20 të datës 23.07.2020

Gjyqtari
 Malsor Kryeziu



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
 Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
 Sallon Depilimi Lume's Details
 lumesdetails
 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

